



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE  
MUNICIPALITY OF GJILAN  
GILAN BELEDIYESI

---

ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/  
BASKAN OFISI

---

**R A P O R T I**  
**I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS**  
**SË GJILANIT**

**JANAR - SHTATOR 2015**

Gjiçan, shtator 2015

## **PËRMBAJTJA**

### **PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE GJATË NËNTËMUJORIT TË VITIT 2015**

Fjala hyrëse

#### **I. AKTIVITETET E DREJTORIVE**

1. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
2. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
3. Drejtoria e Arsimit
4. Drejtoria për Buxhet dhe Financa
5. Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
6. Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim
7. Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë
8. Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
9. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim
10. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

#### **II. AKTIVITETET E ZYRAVE DHE NJËSIVE**

1. Njësia e Kuvendit
2. Njësia për Personel
3. Njësia për të Drejtat e Njeriut
4. Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport
5. Njësia e Auditimit të Brendshëm
6. Zyra Ligjore
7. Zyra për Informim
8. Zyra për Integrime Evropiane
9. Departamenti i Prokurimit
10. Zyra për Komunitete dhe Kthim
11. Zyra për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc

## **PËRMBLEDHJE E ZHVILLIMEVE KRYESORE GJATË NËNTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2015**

Fjala hyrëse:

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës së Gjilanit dhe të gjithë të pranishëm,

Në harmoni me kompetencat e Kryetarit të Komunës së Gjilanit, dhe me qëllim të ngritjes dhe fuqizimit të transparencës në komunë, edhe për kundër faktit se nuk është obligim ligjor, unë si Kryetar i Komunës, ofrojë para jush, këtë raport pune, me qëllim të ofrimit të informatave sa ma të detajuara lidhur me punën e ekzekutivit të Komunës. Ky raport nëntë mujor, përfshinë aktivitetet e të gjitha drejtorive dhe të zyrave.

Për nëntë muajt e kaluar, të dhënat të cilët janë pasqyruar në këtë raport tregojnë se kemi arritur një progres të kënaqshëm, duke i përmbushur kërkesat e qytetarëve të Komunës, duke vazhduar dhe duke qenë çdo herë të gatshëm, për të arritura të mëtutjeshme në punën gjithëpërfshirëse të Komunës.

Angazhimi i ekzekutivit të komunës gjatë kësaj periudhe nëntë mujore, kryesisht është fokusuar në realizimin e kompetencave të plota sa i përket interesit lokal dhe që janë në interes për qytetarët, duke i pasur parasysh prioritetet.

Edhe pse me një buxhet modest sa i përket infrastrukturës, jemi duke i përmbushur nevojat parësore tuajat siç janë: rrugët, ujësjellësi, kanalizimi dhe ndriçimi publik. Njëherit kemi arritur të krijojmë kushte më të mira për qytetarët e Gjilanit, e sidomos për familjet të cilat kanë qenë me nevojë për kushtet elementare të jetesës, duke ndërtuar 16 shtëpi përmes një aksioni humanitar, falë edhe donatorëve të cilët kanë kontribuar në përmbushjen e këtyre nevojave të qytetarëve me nevoja sociale. Nga aksioni humanitar kanë përfituar edhe 40 familje në meremetim të shtëpive, ndërkaq 37 të tjera në pagesë të qirasë.

Lidhur me programin e përbashkët të Kombeve të Bashkuara kundër Dhunës në Familje në komunën e Gjilani, në muajin Janar është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit në mes Komunës së Gjilanit dhe UN Women, për bashkëfinancimin e aktiviteteve që burojnë nga strategjia kundër dhunës në familje 2013-2018 është bërë nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit kundër Dhunës në Familje nga 13 institucione dhe 3 OJQ vendore, dhe krijimi i Mekanizmit Koordinues kundër Dhunës në Familje.

Nga Komisioni Evropian (IPA), të Programit për Bashkëpunim Ndërkufitar Maqedoni-Kosovë, komuna e Gjilanit gjatë muajit Janar 2014 ka hartuar-zhvilluar një projekt propozim të përbashkët me komunën e Çairit në Shkup dhe ka aplikuar me të njëjtin në këtë thirrje më datë 30 Janar 2014 dhe është shpallur fitues pasi ka kaluar të tri fazat vlerësimit.

Projekti ne tersi arrin vlerën rreth 500,000 euro (për të dy komunat), derisa granti për komunën e Gjilanit arrin vlerën prej 241,631.15 euro (duke përfshirë këtu edhe participimin e komunës në vlerë prej 36,244.68 euro), pra granti i Komisionit Evropian për Gjilanin arrin vlerën prej 205,386.47 euro.

Realizimi i projektit do të zgjasë 18 muaj (Prill 2016) dhe se në kuadër të tij ka të përfshirë:

1. Bashkëpunim, koordinim dhe këmbim të përvojave mes dy komunave (Çair dhe Gjilan)
2. Menaxhimin e projektit konform kushteve dhe standardeve të Komisionit Europian
3. Trajnime, konferenca, panairë, vizita, material promovues, etj.
4. Rehabilitimin e hapësirave ku është e vendosur qendra informuese
5. Nën-grante të vogla për ndërmarrësit

Po ashtu angazhimet tona janë orientuar në arsim, shëndetësi, zhvillim ekonomik, bujqësi dhe fusha tjera, njëherit kemi kontribuar që në komunën tonë të mbretërojë një klimë e mirë në aspektin e sigurisë, në mënyrë që të krijojmë kushtet elementare për investime të huaja.

Për t'u njohur më përsëafërmi me të gjitha të arriturat që i përmenda në mënyrë telegrafike dhe për të ju informuar në mënyrë më të detajuar, i keni më poshtë raportet të drejtorive dhe zyrave veç e veç.

## **AKTIVITETET E DREJTORIVE**

### **Drejtoria e Administratës së Përgjithshme**

Raporti i punës së DAP-it për periudhën janar – shtator 2015, paraqet rritje të cilësisë së shërbimeve përmes avantazheve të Teknologjisë së Informatikës dhe menaxhimit të drejtë të Resurseve Humane. respektivisht në motivimin e punëtorëve e cila ka pasur një ndikim të drejtpërdrejt në arritjen e cilësisë totale në shërbimet që ofron DAP.

Angazhimi i në DAP, kryesisht ka qenë në krijimin e hapësirave fizike sidomos për zyrat e këshillave të fshatrave, zyrave mobile të gjendjes civile dhe zyrave të drejtorive të Komunës së Gjilanit:

Implementimi i projektit “Telework” si projekt i parë në Kosovë dhe rajon, unifikimi i mbishkrimeve për 30 objekte dhe sektor të Komunës së Gjilanit, vendosja e aparateve për menaxhimin e kohës në të gjitha drejtoritë komunale, vendosja e kamerave në të gjitha qendrat mobile të GJC, ASHI- Pajisje me mjete teknologjike në vlerë rreth 6000 euro për integrimin e rrjetit, të gjitha përgatitjet për fillimin e implementimit të projektit E-Kioska, meremetimi dhe inventarizimi i zyrës së Këshillit të Fshatit, Përlepnice, Malishëvë, Livoç i Ulët, Cërnicë, Llashticë, Uglarë, meremetimi dhe inventarizimi zyrave të Gjendjes Civile në Malishevë, Bresalc, Vërbic e Zhegocit, Zhegër, Shurdhan, Mireshe, Llashticë dhe Zyra për Luginën e Preshevës, krijimi i zyrave të hapura në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, e cila është bërë në vazhden e projektit “ One Stop Shop”, instalimi i rrjetit të internetit në fshatin Kishnapole, transferi i dosjeve nga Arkivi i DAP në QRA- Prishtinë, intervenimet në hardware/software 620, intervenimet në rrjetin qeveritarë 340, intervenimet tjera (duke përfshi edhe përkrahjen teknike përmes telefonit) 300

Aplikimet Online për periudhën Janar – Shtator 2015 janë gjithsej 1300.

**Shërbimet e ofruara nga SGJC dhe drejtorit tjera, përmes QSHQ.**

Nr	Drejtoritë, zyrat njësitë	Të bartura	Pranuar	Gjithsejtë	Miratim		Refuzim		Pezullim		Gjithsej		Ndryshimi	Lëndë në procedurë	brenda afatit	Pas afatit
	Aktivitetet				librat	programi	librat	programi	librat	programi	libra	programi	1 - P			
1	Kuvendi dhe komitetet		53	53	20						20		20	33	20	
2	Kabineti i Kryetarit		644	644	347						347		347	297	347	
2.1	Zyra e Personelit		180	180	209						209		209		209	
2.2	Zyra e Projekteve		24	24										24		
2.3	Departamenti i Prokurimit		2	2	3						3		3	-1	3	
2.4	Zyra Ligjore		338	338	33						33		33	305	33	
2.5	Zyra lokale e Komuniteteve		30	30	7						7		7	23	7	
2.6	Zyra e Auditorit të Brendshëm		11	11	11						11		11		11	
3	D. e Adm. Të Përgjithshme.		1819	1819	1675						1675		1675	144	1675	
3.1	Shërbimi i Gjendjes Civile		79654	79654	79654						79654		79654		79654	
3.2	Vërtetim identik me origjinalin		321	321	321						321		321		321	
3.3	Gjetje e lëndëve në arkiv		41	41	41						41		41		41	
4	D. Shënd. e Mirëqenie Sociale		613	613	378		58				436		436	177	378	58
5	D. Arsimit		351	351	166		14				180		180	171	166	14
6	D. Buxhet dhe Financa		305	305	229		31				260		260	45	229	31
7	DUPMM		619	619	423		14				437		437	182	423	14
8	D. Inspeksionit		17	17	7						7		7	10	7	
9	D. Shërb. e Publike, Infra. Banim		965	965	731		2				733		733	232	731	2
10	D. Bujqësi e Pylltari		2119	2119	1124		174				1298		1298	821	1124	174
11	Njësia për Kulturë, Rini e Sport		37	37	15						15		15	22	15	
12	D. Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë		3698	3698	1905		587				2492		2492	1206	1905	587
13	D. Mbrojtje dhe Shpëtim		97	97	79						79		79		79	
14	D. e Zhvillimit Ekonomik		237	237	184		20				204		204	33	184	20
15	Qasje në dok. zyrtare		39	39	39						39		39		39	
17	Protokoll		15979	15979	15979						15979		15979		15979	
<b>Gjithsejtë:</b>			<b>108193</b>	<b>108193</b>	<b>103580</b>		<b>900</b>				<b>104480</b>		<b>104480</b>	<b>3724</b>	<b>103580</b>	<b>900</b>

## Sektori i Autoparkut

Duke filluar nga ky vit me kërkesë të MPB- të gjitha automjetet e komunës janë të pajisura me tabela zyrtare dhe atë para kohe (ende pa i skaduar afati i regjistrimit),

Krahasimi i shpenzimeve me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar:

Vitet		Km. e kaluara	Sasia e derivateve	%
2014		288470	27,106.44	9.39
2015		229600	22,150.68	9.65
Dallimi		<b>58870</b>	<b>4,955.76</b>	<b>0.26</b>

Nga raporti shihet se edhe këtë vit kemi rënie të kilometrave të kaluara dhe shpenzimeve me derivate.

## Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

### Sektori për Shërbime Shëndetësore

Për periudhën kohore nëntë mujore janë kryer 366 lëndë.

Numri i kërkesave dhe shpenzimeve sipas periudhave tremuajshe 2015, si dhe krahasimi me të njëjtat periudha të vitit paraprak:

Tabela:1

Viti	Tremujori i parë	Tremujori i dytë	Tremujori i tretë	Gjithsejtë	Shpenzim €
2015	122	146	98	366	35.550
2014	90	106	119	315	38.390

Konstatohet një rritje në numrin e kërkesave për 51 më shumë në 2015, se sa të njëjtën periudhë 2014, por një shpenzim prej 2840 euro më pak në 2015 njëkohësisht.

### Sektori i Shëndetit Publik

6	Ligjërata në shkolla të mesme	tema	Mbrojtja nga abuzimi me substanca narkotike
2	Takime me komunitete	tema	Diabeti
4	Takime me Save Children	tema	Problemi psiko social
18	Vizita te QMF dhe Ambulancave	qëllimi	Mbrojtja e shëndetit të popullatës
46	Vizita terreni	qëllimi	Vizitë palëve, për kërkesa në barëra
5	Komisioni mbikëqyrës për edukim shëndetësor në kuadër të Komunës	qëllimi	Aktivitete për shënimin e ditës botërore të shëndetësisë
720	Takime me palë	qëllimi	Për probleme të sferës shëndetësore

Në bazë të referencës të QKUK-së në Prishtinë nga Komuna jonë për Ministrinë e Shëndetësisë janë referuar 88 raste

Sektori për Ujë - Monitorimin-hulumtimin dhe përcjelljen e kualitetit të ujit të pijshëm

Vizita	Lokacionet, rurale raste të marrjeve të mostrave të ujit	Janë dhënë për çdo xhiro hulumtuese të ujit të pijshëm ;
Institucionet shkollore	<b>48</b>	Rekomandimet zyrtare
Institucionet Shëndetësore	<b>10</b>	Në raste të caktuara për ujin e pijshëm duke u bazuar në analizën kimiko-bakteriologjike të ujit të pijshëm për çdo objekt të furnizimit me ujë të pijshëm në institucionet shkollore dhe shëndetësore.
Burimet, Baja	1	
Çezme Publike	<b>1</b>	
Nr i marrjes së mostrave	60 objekte uji janë hulumtuar me nga 2 mostra uji (60x2=120 mostra )	
Gjithsej marrje të mostrave të ujit për analiza janë realizuar	<b>120</b> mostra uji –janë marrë mostra uji për analizë kimike dhe bakteriologjike Në çdo pikë të mostrave janë marrë nga dy mostra uji kimike dhe bakteriologjike	

#### Ndihmat në sferën sociale

Pagesat për familjet e Dëshmorëve dhe të Invalidëve të Luftës sipas Rregullores Komunale

Familjet	Periudhat	Shuma mujore	Gjithsejtë	Data
15	Dhjetor 2014	130€	1950 €	03.02.2015
15	Janar 2015	130€	1950 €	16.03.2015
15	Shkurt 2015	130€	1950 €	10.04.2015
15	Mars 2015	130€	1950 €	10.04.2015
15	Prill 2015	130€	1950 €	15.05.2015
15	Maj 2015	130€	1950 €	06.07.2015
15	Qershor 2015	130€	1950 €	06.07.2015
15	Korrik 2015	130€	1950 €	11.08.2015
15	Gusht 2015	130€	1950 €	15.09.2015

#### OJQ-të e ndihmuara

Emri i ojqsë	Data e Vendimit	Shuma	Data e ekzekutimit
Shoqata e të verbërve	20.03.2015	1.000€	24.03.2015
Handikos	10.04.2015	3.000€	24.04.2015
Shoqata e të verbërve	21.05.2015	1.500€	25.05.2015
Shoqata e shurdhmemecëve	21.05.2015	500€	25.05.2015
Handikos	21.05.2015	2.500€	10.07.2015

OJQ "Liria"	21.05.2015	4.000€	10.07.2015
Pema	03.07.2015	2.000€	13.07.2015
Shoqata e të verbërve	04.09.2015	1.500€	09.09.2015
Handikos	23.09.2015	1.500€	23.09.2015
Shoqata e shurdhmemecëve	23.09.2015	1.500€	23.09.2015
<b>Gjithsejtë</b>		<b>18.000€</b>	

### Pagesat e rekomanduara nga Komisioni ad hoc.

Familjet	Periudhat	Shuma mujore	Gjithsej	Data
30	Korrik 2015	52 € -100 €	2737 €	17.09.2015
30	Gusht 2015	52 € -100 €	2737 €	17.09.2015

Pasi që familjes së Safete Mustafa, është duke iu ndërtuar shtëpia nga donatorët, me rekomandimin e komisionit ad hoc, drejtoria e DSHMS-së, familjes në fjalë, do t'ia kompensoj qiranë për tre muaj në vlerë prej 80€ për muajt mars-maj 2015

Me rekomandim të zyrës së Kryetarit kemi pagatitur një listë për KFOR-in Turk për ndihma familjeve me nevojë, 50 familje të cilat i kanë tërhequr ndihmat nga familjarët. Në bashkëpunim me QPS-në, kemi ndarë ndihma për Kurban Bajram **50 familjeve si dhe 350** familje nga **5kg** kanë përfituar mish nga **Shoqata Bereketi**.

Zyra Administrativo – Juridike

Aktet e prodhuara

Totali	Për barëra	aprovime	refuzime	Për qira	Për z. e Kryetarit	Për familjet e zhvendosura	Të ndryshme
<b>586</b>	<b>474</b>	<b>364</b>	<b>110</b>	<b>30</b>	<b>26</b>	<b>8</b>	<b>48</b>

### Inspeksioni Sanitar

Janë vizituar 42 institucione private shëndetësore dhe janë lëshuar 38 Aktvendime mbi pëlqimin Sanitar për funksionimin e tyre.

Janë inspektuar 72 subjekte të ndryshme, ku janë hartuar 60 procesverbale.

### Aktiviteti i QPS-së;

Kërkesa të pranuar	205
Aprovuar	156
Refuzuar	37
Në procedurë	12
Numri i familjeve të verifikuara dhe të ri-verifikuara	1208
Janë aprovuar	1066
Refuzuar	140
Në procedurë	2
Për Komision mjekësor	663



Aprovuar	642
Refuzuar	17
Në procedurë	04

### Aktivitetet tjera

Ankesat e palëve	19
Shqyrtuar	19
Aprovuar	05
Refuzuar	05
Në procedurë	09

Familjet skamnore janë ndihmuar me pako ushqimore.

### Shërbimet Sociale dhe Familjare

Nr	Kategoria Sociale	Viti 2015
1	Fëmijët jetim	1
2	Fëmijët e braktisur të porsalindur dhe më vonë	3
3	Kërkesat për adoptime vendore	6
4	Viktimat e dhunës në familje	26
5	Të miturit (delikuentet-kundërvajtje dhe penale)	73
6	Të moshuarit	4
7	Kujdestari për të rriturit	3
8	Problemet bashkëshortore( shkurorëzime-ndarje)	30
9	Fëmijë me sjellje asociale	16
10	Klient tjerë ( konstatime, vërtetime, shtetësi, punë, taksi, kujdestari etj.	440
11	Familje që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme	16
12	Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrës prindërore	1
13	Fëmijët e përfshirë në punë	11
14	Fëmijët e keqtrajtuar	--
15	Viktimat e trafikimit	--
16	Martesa e të miturve	--
17	Totali:	630

### QKMF- Gjilan

Kemi bërë riorganizim funksional brenda QKMF-së, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të shërbimeve që ofrohen qoftë nga pjesa administrative ashtu edhe ajo mjekësore. QMF-të në Pogradë, Cërrnicë, Malishevë, Miresh, tani kanë mjekun për çdo ditë pune. Punktet në Uglarë, Livoq i Ulët, Llashticë, Përlepticë, Kishna Pole, infermierja punon 5 ditë në javë ndërsa mjeku 2-3 ditë në javë. Në muajin shtator kemi filluar me pjesën e mbetur të renovimeve për qendrat e caktuara edhe atë: QMF Ramiz Cërrnica, QMF 28 Nëntori, QMF Livoq i Ultë, QMF Miresh, QMF Zhegër, pjesërisht AMF Uglarë-dhoma e intervenimeve.

Shërbimet shëndetësore për këtë nëntë mujor në mënyrë tabelare.

1.	Vizita në Mjekësinë Familjare	153460
2	Referime	27391 17.84%
3	Vizita shtëpiake	2674
4	Injeksione	79643 / 51.89%
5	Infuzione	8415 / 5.48%
6	Vizita Stomatologjike	16807
7	Shërbime të Laboratorit	14299

Tabela:1. shërbimet shëndetësore

Shërbimet	Gjithsejtë vizita	M	F	Vizita gjat dites	Vizita Gjat nates	Vizita shtepiake	Referime gjat ditës	Referime gjat natës	Ingjeksione	Infuzione	Lidhje	Inhalime	Participim
Mjekësia familjare	115239	53761	61478	1E+05	0	0	25449	0	50235	5402	2643	2354	19369
Ndihma e shpejtë	30585	13733	16852	10291	20294	2674	1200	240	27791	2969	718	648	7212
Stomatologjia	16807	7674	9133	0	0	0	0	0	0	0	0	0	937
Laboratori	14299	5590	8709	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2487
Shërbimi Paliativ	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kujdestaria e fëmijëve	5162	2567	2595	0	0	0	417	0	1594	26	113	166	0
Qendra e Diabetit	2389	898	1491	0	0	0	85	0	23	18	27	0	0
Qerdhet e qytetit	85	45	40	85	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>184566</b>	<b>84268</b>	<b>100298</b>	<b>1E+05</b>	<b>20294</b>	<b>2674</b>	<b>27151</b>	<b>240</b>	<b>79643</b>	<b>8415</b>	<b>3501</b>	<b>3168</b>	<b>30005</b>

Tabela: 2

## Sëmundjet ngjitëse

Sipas moshës	0-4 vjet	5-49 vjet	50 e mbi	Totali
Pneumoni	327	324	245	896
SARI (infeksionet akute respiratore të rënda)	40	44	22	106
Diarre akute	781	1028	489	2298
Variçuell	85	86	14	185
Dyshimi në influencë-(ILI)	222	658	389	1269
Dyshimi në rubeolë				0
Dyshimi në verdhëzën akute				0
Dyshimi në parotitin epidemik				3

Tabela: 3

## Shërbimi i vaksinimit

Emri i Vaksinës	0-11 muaj	12-23 muaj	24-59 muaj	mbi 59 muaj	Totali	Emri i vaksinës	12-23 Muaj	Mbi 23 muaj	Totali
BCG në maternitet					0	OPV R1 (12-18 m)	633	28	661
BCG					0	DP R1 (12-18m)	806	28	834
OPV1	890				890	OPV R2 (6-7vj)	1194		1194
OPV2	904	2			906	DT (6-7vj)	1194		1194
OPV3	903				903	MMR r(6-7vj)	112		112
DPT1+Hib1+hep B1	970				970	OPV R3(12-13vj)	1458		1458
DPT2+Hib2+hep B	898				898	Td(12-13vj)	1458		1458
DPT3+Hib3+hep B3	905				905	TT(18vj)	1852		1852
Hep.B1 ne maternitet					0	Vaksinat tjera			0
Eep.B2					0				
Hep.B3									
MMR		882	22		904				

Tabela:3

## Shërbimet e SESSH-IT

Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Totali
71	1013	1779	902	1358	1773	1105	296	429	8726
511	1243	2133	905	295	1984	1569	372	412	9424
231	690	1441	391	501	988	1056	442	821	6561
267	853	1365	345	309	961	799	72	580	5551
215	580	1052	kont. Sistematike	127	345	398	30	439	3186
262	104	Kont.. Sistematike	kont.. Sistematike	kont.. Sistematike	0	183	103	348	1000
Pushim Vjetor	882	1443	775	807	612	1177	350	790	6836
1557	5365	9213	3318	3397	6663	6287	1665	3819	41284

**Drejtoria e Arsimit**

Për një zhvillim sa më cilësor e bashkëkohor të procesit mësimor, DKA-ja ka hartuar politikat dhe objektivat zhvillimore për ngritjen e cilësisë dhe reformave në arsimin e komunës së Gjilanit:

Përmes projekteve e në bashkëpunim me MASHT-in, DKA-në, BEP-USAID-in, GIZ-it, Save the Children, KCIC, Qendra për Studime të Avancuara, FIT, KEC Institutit Pedagogjik i Kosovës, është mundësuar ngritja e kapaciteteve të personelit arsimor në zbatimin e metodologjive të reja bashkëkohore për mësimdhënie:

1. Vazhdimi i rikualifikimit të mësimdhënësve në Fakultetin Publik të Edukimit “ Kadri Zeka “ në Gjilan të cilët kishin të mbaruar vetëm Shkollën e Lartë Pedagogjike.
2. Përgatitja dhe mbajtja e Testit PISA 2015, më 16.04 2015, në 12 shkolla të përzgjedhura në Komunën e Gjilanit,
3. Përgatitja e teknike dhe administrative për mbajtjen e testit të arritshmërisë për klasat e IX-ta të 25 shkollave në 7 qendra testimi.
4. Mbajtja e ligjëratave informuese për rreziqet në internet për nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit nga Qendra për Studime të Avancuara ( FIT ),
5. Vlerësimi i planeve zhvillimore të shkollave fillore e të mesme nga komisioni vlerësues i GIZIT dhe ndarja e shpërblimeve për shkolla si dhe
6. Trajnimi i mësimdhënësve të shkollave pilot.
7. Sigurimi i projekteve dhe zotimi i mjeteve financiare për dy salla të ed.fizike për shkollat fillore “ Abaz Ajeti “në Gjilan dhe Liria në Pogradje.
8. Vendosja e gurë themelit të shkollës fillore “ Bajram Curri “ në fshatin Shurdhan e cila do të jetë në shërbim të nxënësve nga fundi i nëntorit 2015
9. Përfundimi i procedurave për ndërtim të aneksit të shkollës fillore në fshatin Ponesh për nxënësit e dy komuniteteve, shqiptare e serbe, me donacion të USAIDIT dhe Komunës së Gjilanit,
10. Fillimi i ndërtimit të shkollës së Artit Pamor por për arsye të pashpjeguara përveçse është thënë se mungon buxheti, punimet janë ndërprerë.
11. Janë në përfundim punimet e ndërtimit të sallës së edukatës fizike për Gjinnazin e Shkencave Natyrore “ Xhavit Ahmeti”
12. Fillimi i zbatimit të projektit për kompleksin e shkollave të mesme.
13. Pranimi i drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve të institucioneve edukativo arsimore,

14. Mbajta e Olimpiadës Matematikore-OMLGJ 2015, me nxënës të klasave IX, X, XI, XII, me rreth 100 nxënës.

Drejtoria komunale e Arsimit, përveç monitorimit të procesit mësimor, ngritjes së cilësisë në arsim, kujdes i veçantë i kushtohet edhe mirëqenies shëndetësore të nxënësve dhe sigurisë në shkolla. Në bashkëpunim me Qendrën e Mjekësisë Familjare është bërë kontrolli i nxënësve në shkolla, kontrolli i ujit dhe kontrolli i higjienës. Bashkëpunim i mirë në mes të Drejtorisë së Arsimit dhe Shërbimit të Policisë së Gjilanit, ka bërë që në shkollat tona të kem edhe një siguri të mirë dhe të mbahet praktika profesionale me nxënës të shkollës teknike “Mehmet Isai”, të profilit të komunikacionit.

Përfundimi i procesit mësimor për klasat e IX-ta e klasat e XII-ta, organizimi i mbrëmjeve të maturës, përgatitja teknike e qendrave të testimit për mbajtjen e testit të arritshmërisë dhe testit kombëtar, përzgjedhja e 132 administruesve për të administruar testin kombëtar të nxënësve maturantë në komunën e Vushtrrisë e 60 mbikëqyrësve që kanë përcjellë testin e maturës kombëtare të maturantëve në shkollat e Prishtinës, ishin detyra me përgjegjësi të lartë të zyrtarëve të DKA-së. Falë një përkushtimi të mirë, këto aktivitete u kryen në mënyrën më të mirë.

Testi kombëtar, i pjesës së parë u mbajt më 06.06 2015 dhe pjesa e dytë më 20 qershor. Kësaj here, testi kombëtar u mbajt nën administrimin e mësimdhënësve nga komuna e Lipjanit dhe mbikëqyrësit nga komuna e Prizrenit. Komisionin e përbënin: komisionarë nga MASHT-i drejtorët e shkollave dhe zyrtarë të DKA-se. së Gjilanit. Testi kombëtar këtë vit u mbajt në lokale të mbyllura (klasë) me numër të vogël nxënësish, ku në çdo klasë pati vetëm nga 15 nxënës që administroheshin nga një administrues

Me 18 qershor Drejtoria Komunale e Arsimit shpall konkursin për regjistrimin e nxënësve në klasa të dhjeta në shkollat e mesme të arsimit të lartë. Në shtatorin e vitit 2015/2016 në klasat e X-ta, do të regjistrohen 1950 nxënës, duke i përfshirë edhe ata nga komunat e regjionit që do të regjistrohen në shkollën e mjekësisë (2 paralele me nga 32 nxënës në klasë). Gjithashtu, edhe në shkollat fillore të arsimit të mesëm të ulët në klasë të parë janë regjistruar 1307 nxënës.

Drejtoria Komunale e Arsimit, në fund të qershorit sipas të dhënave të dërguara nga drejtorët e shkollave, analizoi me kujdes në secilën shkollë normat mësimore për lëndë. Për vendet e lira në disa shkolla të arsimit të mesëm të ulët dhe arsimit të mesëm të lartë, DKA-ja shpalli konkurs për vitin shkollor 2015/2016.

Meqë katër shkolla në komunën tonë janë shkolla pilot projekte : “Musa Zajmi” ,” Rexhep Elmazi” ,” Mehmet Isai “ dhe Gjinnazi Natyror”, mësimdhënësit e këtyre shkollave ndjekin trajnimet për ngritje profesionale për zbatimin e Kornizës Kurrikulë Kombëtare, organizuar nga MASHT-i, përkatësisht Departamenti i Inspektimit .

DKA-ja ka dërguar në zyrën e projekteve kërkesat me prioritet për ndërtime të reja në infrastrukturën shkollore për vitin 2016/2017: Shkolla të reja 5: “ Mehmet Isai”, Asllan Elezi”(nëse universiteti publik” Kadri Zeka” nuk i liron objektet), shkolla fillore në fshatin Haxhaj, “Vuk Karaxhiq” në fshatin Shillovë, çerdhe për fëmijë në Dardani, 6 Salla të Edukatës fizike “ Dëshmorët e Kombit”, “Agim Ramadani”, “Rexhep Elmazi”, Lagjja II, “Vatra e Diturisë”, “Arbëria”, renovimin, fasadimin, gëlqerosjen dhe riparimin e njeve sanitare në institucionet arsimore në prioritet, sipas planit të hartuar më parë.

Me vendim, Kuvendi Komunal i ka aprovuar kërkesat e DKA-së për ndarje të bursave nxënësve të shkëlqyeshëm të cilët do të dëshirojnë të regjistrohen në shkollën e Agrobiznesit “ Arbëria”. Ky hap pozitiv është ndërmarrë me qëllim të motivimit, përmirësimit e cilësisë dhe shtimit e numrit të nxënësve në profesionet e agrobiznesit.

Më 8 qershor 2015, Kryetari i Komisionit Parlamentar të Arsimit z.Nait Hasani, pati takim në DKA me drejtorët e Drejtorive Komunale të Arsimit në regjion, drejtorët e shkollave të Arsimit të Mesëm të Lartë,

Kryetarët e Këshillit të Prindërve, Kryetarët e Rinisë Shkollore. Qëllimi i takimit ishte debat për Projektligjin e Maturës Shtetërore, i cili do të procedohet në Parlament, pas dëgjimit publik.

DKA-ja, në bashkëpunim me shkollën “Abaz Ajeti”, Çerdhen INTEXH, Fëmijët me nevoja të veçanta, Asamblenë e Fëmijëve dhe zyrën e Kryetarit, me një program të larmishëm, organizoi manifestim për shënimin e Ditës Botërore të Fëmijëve.

### Sfidat

1. Menjëherë në muajin janar, me fillim të gjysmë vjetorit të parë 2015, shkollat tona u ballafaquan me dukurinë e migrimit të një numri të madh nxënësish mbi 400. Të gjithë ata nxënës që patën fatin të kthehen sërish në Gjilan, me urdhëresë administrative të MASHT-it u integruan në shkollat ku kanë qenë dhe me gjeneratën e tyre të shkollimit. Me këta nxënës u mbajt mësime plotësues në lëndët: gjuhë shqipe, matematikë e lende tjera.
2. Shqetësimi për numrin e vogël të nxënësve për t’u regjistruar në shkollën e Agrobiznesit “ ARBËRIA”.
3. Sfida e së ardhmes do të jetë teprica teknologjike e mësimdhënësve, si rrjedhojë e mungesës së normave mësimore si pasojë e numrit të vogël të nxënësve, buxhetit të pamjaftueshëm për paga, shërbime dhe mallra, transporti i nxënësve dhe subvencionet e vogla për bursa të nxënësve dhe studentëve.

NR	PAJISJA E INSTITUCIONEVE ARSIMORE ME INVENTAR	Çmimi
1	Shkolla Filllore “Selami Hallaqi”: inventar për zyre, klasa, bibliotekë, salla e arsimtarëve	15,540.00
2	Shkolla Filllore “ Skënderbeu”: Inventar për zyre	8,792.50
3	Shkolla Filllore “ Liria” : Pajisje e klasës për parashkolloret	1,598.00
4	Shkolla Filllore ”Ibrahim Uruqi”: Inventar për zyre, tavolina e karrige	11,036.60
5	Shkolla Filllore “ Mulla Idriz Gjilani “ Inventar për zyre	4,982.00
6	Shkolla Filllore “ Abdulla Tahiri “ inventar për zyre	5,683.30
<b>Gjithsejtë</b>		<b>47.63.40</b>

Më datën 05 shtator 2015, u mbajt pjesa e dytë e testit të Maturës Shtetërore, që iu nënshtruan 781 nxënës në 9 qendra testi. Administrimin e procesit e bënë 45 administrues nga komuna e Lipjanit, 13 monitorues nga Komuna e Prizrenit, 13 komisionar nga MASHT dhe drejtorë të shkollave. DKA-ja angazhoi 67 mësimdhënës për ta administruar testin e Maturës Shtetërore në komunën e Vushtrrisë, ndërsa 25 mësimdhënës për monitorim të testit të Maturës Shtetërore në Prishtinë, me organizim të transportit. Për të pasur një arsim cilësor, modern e bashkëkohor, krahas potencialit intelektual është i domosdoshëm buxheti dhe infrastruktura shkollore. Buxheti i arsimit, si përherë edhe tani, jo vetëm për komunën e Gjilanit, por edhe në komunat tjera të Kosovës është tepër i vogël për të përmbushur kërkesat dhe nevojat në fushën e arsimit.

## Drejtoria për Buxhet dhe Financa

### Aktivitetet e drejtorisë:

1. Pasqyrat vjetore 2014 për MF,
2. Raportin financiar 2014 për Kuvend ,
3. Raportet financiare të tremujorit të parë dhe tremujorit të dytë për Kuvend
4. Kornizën afatmesme buxhetore 2016-2018
5. Planifikimin e buxhetit 2016 dhe vlerësimet e hershme 2017-2018 në të gjitha fazat.

6. Rrjedhën e parasë (plani i keshit) për të gjitha njësit buxhetore dhe gjitha kategoritë ekonomike dhe atë në fillim të vitit, pas transferit në Arsim dhe pas rishikimit të buxhetit
7. Shpërndarja e mjeteve të bartura nga viti 2014
8. Formimi i dokumentacioni për kode të projekteve dhe alokimin e tyre nga MF
9. Analiza dhe alokimi i të hyrave (p.sh: raporti i alokimeve për Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Komunali, Investime Kapitale dhe Subvencione).
10. Kemi punua në alokimet mujore për Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime dhe Komunali për çerdhet, arsimin fillor dhe të mesëm (analitikë për çdo çerdhe, konvikt dhe shkollë).
11. Analiza e Pagave dhe Mëditjeve për të gjitha programet buxhetore.
12. Formimin e dokumentacionit nga participimet dhe donacionet për rritje të buxhetit dhe alokimin e mjeteve.
13. Bashkëpunimi i ngushtë me auditorët e jashtëm
14. Pranojmë të gjitha raportet e të hyrave nga BQK
15. Përpunojmë të gjitha të hyrat sipas kodeve dhe drejtorive.
16. Regjistrojmë të gjitha të hyrat në akces.
17. Regjistrojmë të gjitha të hyrat dhe shpenzimet në SIMFK.
18. Përgatisim për të gjitha drejtoritë raporte të të hyrave javore (39 raporte), mujore (9 raporte).
19. Bëjmë barazime ditore me BQK dhe bankat komerciale.
20. Barazime mujore me MF-Thesar
21. Barazime tre mujore me MF, zyrën e kontabilitetit.
22. Përgatisim në baza ditore raporte për të hyrat për secilën drejtori (183 raporte).
23. Përgatisim UNIREF-at për të gjitha faturat e drejtorive
24. Mbajmë evidencë analitike për çdo lloj të hyre.
25. Mbajmë evidencë analitike për të gjitha shpenzimet në përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë të cilët i mbajnë vet .
26. Shtypim listat e pagave të dërguara nga Menaxheri i zyrës Personelit i dërgojmë për verifikim nga drejtorët përgjegjës dhe nënshkrim nga shërbyesit civilë me përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë të cilët i kryejnë vet.
27. Në arkiv janë protokolluar 19716 lëndë
28. Kemi bërë shpërndarjen e faturave të Tatimit në Pronë (31576 fatura)
29. Gjatë punës vjetore bëjmë shtypjen e faturave të Tatimit në Pronë me kërkesë të tatimpaguesve dhe lëshojmë vërtetime të ndryshme (19330 vërtetime) .
30. Janë regjistruar 479 objekte të reja.
31. Deri në këtë periudhë kemi pranuar dhe shqyrtuar 210 Ankesa
32. Gjatë kësaj periudhe buxhetore janë zotuar 4071 lëndë regjistruar si shpenzim, 3800 lëndë, certifikuar, fotokopjuar dhe arkivuar në arkivin e thesarit komunal (3748 lëndë)
33. Përcjellim regjistrimin dhe transferet e inventarit
34. Është bërë regjistrimi i shpenzimeve kapitale në SIMFK 127 lëndë

Tab.1

Të hyrat nga tatimi në Pronë	Planifikimi 2015	Realizimi i të hyrave Janar-Shtator 2014	Realizimi i të hyrave Janar-Shtator 2015	Krahasimi mes realizimit 2014 dhe 2015	% në mes planifikimit dhe realizimit 2015
	<b>1,360,953.00</b>	<b>1,001,533.33</b>	<b>935,739.73</b>	<b>93.43</b>	<b>68.76</b>



Tab.2

Pagat	123.646,63€
Mallra dhe shërbime	25.868,91€
Shpenzime komunale	5.681,69€
Gjithsejtë shpenzimet	<b>155.197,23€</b>

**Planifikimi dhe realizimi i të hyrave Vetanake për Janar- Shtator 2015**

Tab.3

Përshkrimi	Planifikimi 2015	Realizimi i të hyrave Janar-Shtator 2014	Realizimi i të hyrave Janar-Shtator 2015	Krahasimi mes realizimit 2014 dhe 2015	% në mes planifikimit dhe realizimit 2015
Të hyrat nga DAP	170,000.00	109,239.65	99,738.05	91.30	58.67
Të hyrat nga Qiraja	90,000.00	29,304.00	54,309.89	185.33	60.34
Të hyrat nga Zhvillimi ekonomik			16,144.00		
Të hyrat nga biznesi (taxat kom.)	150,000.00	91,553.40	73,213.06	79.97	48.81
Të hyrat nga lejet e ndërtimi	680,000.00	349,869.50	584,896.50	167.18	86.01
Të hyrat nga shërbimet publike	100,000.00	72,315.00	83,615.53	115.63	83.62
Të hyrat nga Gjeodezia	165,000.00	144,363.80	144,864.55	100.35	87.80
Të hyrat e drejtorisë së Kulturës	14,000.00	9,340.00	6,029.00	64.55	43.06
Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve	150,000.00	125,015.50	128,900.00	103.11	85.93
Të hyrat nga Inspeksioni	45,000.00	17,510.00	3,060.00	17.48	6.80
Të hyrat nga tatimi në Pronë	1,360,953.00	1,001,533.33	935,739.73	93.43	68.76
Gjobat në trafik	320,000.00	316,790.50	194,038.00	61.25	60.64
Gjobat e gjykatave	180,000.00	174,564.00	149,803.52	85.82	83.22
Të hyrat e Drejtorisë së Bujqësisë	15,000.00	3,209.71	8,513.40	265.24	56.76
Të hyrat nga Arsimi	240,000.00	140,095.10	138,077.37	98.56	57.53
Të hyrat nga Shëndetësia	180,000.00	59,512.90	58,600.21	98.47	32.56
Të hyrat e Shërbimeve Publike-Banesat			352.00		
Kthimi i mjeteve me vendim Gjykatave			1,475.80		
<b>Të hyrat komunale</b>	<b>3,859,953.00</b>	<b>2,644,216.39</b>	<b>2,681,370.61</b>	<b>101.41</b>	<b>69.47</b>

Sqarim: te të hyrat mungojë gjobat e gjykatave për korrik, shtator që priten të alokohen këto ditë

Shpenzimet e paguara në Komunën e Gjilanit për periudhën 01.01.2015-30.09.2015 janë:

Tab.4

Pagat dhe mëditjet	10.638.256,54€
Mallra dhe shërbime	1.924.790,06€
Shpenzimet komunale	416.833,02€
Subvencione	392.429,89€
Shpenzimet kapitale	1.765.656,66€

<b>Gjithsejtë:</b>	<b>15.137.966,17€</b>
--------------------	-----------------------

## Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Gjatë periudhës Janar-Shtator 2015 Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka kryer këto aktivitete:

### Spektori i Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit

Aktivitetet të cilët janë kryer gjatë kësaj periudhe:

Tipologjia lëndëve	njësia	Nr i lëndëve të shqyrtuara	njësia	Lëndët në proces të shqyrtimit
Parcelime	copë	40	copë	5
Informata	copë	35		
Propozim zgjidhje	copë	2		
Gjithsej	copë	77	copë	5

Aktivitetet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe:

1. Përfundimi i hartimit të profilit dhe analiza e skenarëve të mundshëm për PRRU” Zabeli 1”
2. Mbushja e aplikacioneve për Legalizimin e objekteve pa leje për qytetarët
3. Përgatitja e dokumentacioneve shtesë për aplikuesit në lidhje me
  - a) Planin Rregullues të Hollësishëm “Fidanishte 2”
  - b) Planin Rregullues të Hollësishëm ”Qendra 2”
  - c) Planin Rregullues të Hollësishëm ”Qarku 3 “
  - d) Planin Rregullues të Hollësishëm Lagja e Spitalit “
  - e) Hartimi i profilit për Planin Rregullues Urban “Tuneli”
4. Hartim i profilit për Planin Rregullues të Hollësishëm “Qendra 4” si dhe Skenarët e mundshëm
5. Dalje në terren për incizimin e objekteve për nevoja të kërkesave në drejtori
6. Komision për vlerësimin e “Hartimi i projekteve kryesore për nevojat e Komunës së Gjilanit ”
7. Propozim zgjidhja e hapësirës publike para Xhamisë ekzistuese të lagjes Zabeli
8. Propozim zgjidhja e hapësirës publike për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Velekincë
9. Debat Publik me qytetarët për PRr H. “Qendra 4”me datën 24.03.2015
10. Punë rreth udhëzuesit të këshillit komunal për Planifikim Hapësinor
11. Debat Publik me qytetarët për hapjen e rrugëve bazuar në Planin Rregullues Urban “Fidanishte”
12. Takim me qytetarët e zonës për PRr H. “Qendra 4”me datën 29.05.2015
13. Përgatitja e dokumentit rreth inicimit për revidim të Planit Rregullues” Qendra – Zona -I-”
14. Përgatitja e dokumentit rreth propozim zgjidhjes së Lokacionit për Varrezat e Qytetit dhe fshatit Velekincë

### Mbrojtje të Mjedisit

**Aktivitetet:**

1. Përgatitja dhe përmbyllja e fazës së parë në projektin ARIS -Sistemi i Adresave.

2. Nxjerrja e koordinatave për pëlqimet për parcelim
3. Sistemimi i planeve rregulluese në sistemin GIS
4. Caktimi i kushteve mjedisore në kuadër të PZHK dhe PRRU
5. Caktimi i kushteve për pajisje me leje mjedisore
6. Pjesëmarrje në takime të ndryshme në MMPH
7. Mirëmbajtja e databazës dhe pjesës grafike si dhe azhurimi në procesin e planifikimit në GIS

## Sektori i lejeve

### Aktivitet

1. Punë në zyre shqyrtimi i lëndës
2. Punë me palë dhe shqyrtim i kerkesave
3. Mbledhja dhe përpunimi i shënimeve për plotësimin e lëndës
4. Takime të ndryshme zyrtare dhe aktivitet punuese
5. Jep pëlqime për ndërtimin, kontrollon dokumentacionin teknik
6. Në terren sipas kërkesës së qytetarëve dhe vizita në vendin e ngjarjes

### Aktivitet shtesë:

1. Informimi rreth procedurave të legalizimit
2. Komision-vlerësimi i dëmeve nga vërshimet
3. Komision vlerësimi i ofertave –asfaltimi i rrugëve në pjesë të ndryshme të qytetit
4. Komision –prerja e punëve –Qendra Memoriale
5. Komision –Vlerësimi i konkursit-Hartimi i planeve rregullues „Fidanishte-2
6. Komision-Pranimi teknik –Objektet e banimit individual për leje përdorimi
7. Mbikëqyrja dhe kontrollimi i punimeve në objektet komunale, shkollore dhe ambulancave “Mirëmbajtja teknike e Objekteve Komunale”
8. Punimi i paramasës dhe paralogarisë për Kompleksin e shkollave të mesme dhe përfundimi i projektit –dorëzimi në zyrën e Prokurimit
9. Punimi i projektit ideor dhe paramasës i zyrave të salla e Kuvendit dhe dorëzimi në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme ( drejtorit, Nazim Gatica)
10. Punimi i projektit ideor i sallës së Kuvendit dhe dorëzimi në DUPMM
11. Punimi i projektit ideor dhe paramasës i zyrave të objekti i Ekzekutivit dhe dorëzimi në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik
12. Kompletimi i projektit kryesor- ndërtimi i sallave të edukatës fizike në fshatin Pogragjë dhe në Shkollën fillore “Abaz Ajeti”, dhe hartimi i projektit ideor aneksi i shkollës në fshatin Ponesh.

### Pranimi i kërkesave

Parcelim të truallit	224
Kushtet e Ndërtimit	117
Leje Ndërtimi	107
Leje të Përdorimit	5
Leje Rrërimi	14
Ankesa	15
<b>Gjithsejtë</b>	<b>482</b>

## Kërkesa të shqyrtuara Janar- Shtator 2015

Parcelim të truallit	177
Kushtet e Ndërtimit	82
Leje Ndërtimi	101
Leje të Përdorimit	1
Lajmërimet (Konkluzat)	45
Refuzime të kërkesave	16
<b>Gjithsejtë</b>	<b>422</b>
Kërkesa në shqyrtim	<b>60</b>

Shuma e pagesave nga Lejet e Ndërtimit për periudhën janar-shtator 2015 është; **580203.00€** i zberthyer në m<sup>2</sup> : 98183.5 m<sup>2</sup>

janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	Gusht	shtator
1,407.00 €	9,711.00	73,815.00	72,084.50	15,126.00	109,442.50	77,169.00	27,947.00	193,501.00

Krahasimet:

Për periudhën Janar-Shtator 2013 të hyrat nga lejet 379797.44€

Për periudhën Janar-Shtator 2014 të hyrat nga lejet 345925.00€

## Spektori i Inspeksionit të Ndërtimit

Inspektimet në mënyrë tabelare:

Nr.	Përshkrimi i punës	Dënime	Gjithsejtë0:
1	Inspektime në terren		480
2	Procesverbale për ndërprerje të punëve		105
3	Vendime për ndërprerje të punëve		91
3	Procesverbale për ndërprerje të punëve-shiritimi objekteve		30
4	Vendime për rrënimin e objekteve		30
5	Dënime mandatore	800€	7
6	Kallëzime penale për Gjykatë		8
7	Konkluzat për rrënimet		/
9	Kërkesa -Ankesa qytetare për shqyrtim		8

## Spektori i legalizimit

Procesi i legalizimit në Komunën e Gjilanit ka filluar në të njëjtën ditë si në gjithë territorin e Republikës së Kosovës me datën 12.01.2015, dhe ka përfunduar me datën 11.06.2015. Gjatë kësaj periudhe në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtjes të Mjedisit janë paraqitur gjithsej 7560 aplikacione nga qytetarët. Në ndërkohë nga stafi i zyrës së legalizimit janë evidentuar edhe 24425 si dhe 56 objekte të kategorisë së III të, të regjistruara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor MMPH, të cilat i përkasin operatorëve PTK dhe IPKO, që në total në regjistrin e ndërtimeve janë 32128 objekte, në tërë territorin e Komunës së Gjilanit, ku u janë vendosur kode dhe koordinatat për secilin objekt, dhe jemi në proces të evidentimit të

objekteve me leje nga të dhënat e disponueshme që i kemi në arkivin e drejtorisë si dhe nga vet qytetarët. Nga numri i përgjithshëm i aplikacioneve 6266 janë nga zona urbane dhe 1294 aplikacione janë paraqitur nga zonat rurale, ndërsa numri objekteve të evidentuara në zonën urbane është 9090 dhe 15425 objekte në zonat rurale.

Pas kësaj periudhe është filluar me përpilimin e regjistrimit të ndërtimeve pa leje, të atyre të cilët kanë aplikuar dhe atyre që DUPMM gjatë periudhës së regjistrimit, u ka vendosur kode identifikuese që t'u bëhet e mundur të gjithë atyre që nuk kanë mundur të paraqiten për regjistrim për arsye të ndryshme që të aplikojnë për legalizim në fazën e dytë e cila ka filluar nga data 16.09.2015

Komuna	Nr i përgjithshëm i objekteve	Nr. Objekteve që kanë aplikuar për legalizim	Nr. Objekteve të evidentuar	% objekteve që kanë aplikuar
<b>Gjilan</b>	<b>32128</b>	<b>7560</b>	<b>24515</b>	<b>23.53%</b>

Tabela: sipas vendit.

Vendi	Nr i përgjithshëm i objekteve	Nr. Objekteve që kanë aplikuar për legalizim	Nr. Objekteve të evidentuar
Gjilan	15356	6266	9090
Bilinicë	190	1	189
Bresalc	1054	46	1008
Bukovik-Capar	125	1	124
Burincë	19	4	15
Lipovicë	23	1	22
Cërrnicë	1343	58	1285
Dobërqan	1040	53	987
Kishnapolë	221	0	221
Gadish	137	3	134
Sllakovc i Epërm	110	0	110
Sllakovc i Ulët	63	0	63
Goden i Vogël	22	1	21
Kmetoc	527	51	476
Kravaricë	126	2	124
Livoq i Ulët	1274	273	1001
Livoq i Epërm	1079	171	908
Lladovë	286	15	276
Llashticë	640	24	616
Llovcë	138	1	137
Malishevë	1307	88	1219
Muqibabë	63	4	59
Inatovc	50	0	50
Nasal	133	2	131
Përlepnice	828	122	705
Pidiq	75	0	75
Pogragjë	681	16	665
Poneshë	710	11	699

Shillovë	928	69	852
Shurdhan	47	4	43
Stanciq	27	0	27
Dunav	22	0	22
Çelik	30	0	30
Sllubicë	60	1	59
Stublinë	61	1	60
Uglarë	388	11	377
Velekincë	604	171	433
Vërbic e Kmetocit	144	15	129
Vrapçiq	112	1	111
Zhegër	1641	80	1561
Vërbic e Zhegovcit	275	1	274
Zhegovc	122	0	122
PTK&Ipko	56	56	

### Objektivat me prioritet të DUPMM për vitin 2015

1. Shqyrtimin e drejtë dhe efikas të kërkesave të ndryshme të qytetarëve
2. Hartimi i elaboratit të shpronësimeve –interesave publike brenda PRRU-të aprovuara (sipas nevojave)
3. Implementimin sa më efikas në terren të PRRU-ve të miratuara.
4. Hapjen e korridoreve të reja – rrugëve lidhëse dhe përmbledhëse dhe hapësirave tjera publike në kuadër të PRRU
5. Caktimi i lokacionit dhe propozim zgjidhja e planit të varrezave të qytetit
6. Përfundimi i projektit të ARIS dhe monitorimi i tij në të ardhmen (sistemi i adresave)
7. Përcjellja e procesit të zbatimit të Ligjit për trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, Nr. 04/L-188
8. Regjistrimi i objekteve të ndërtuara pa leje
9. Riorganizimi i drejtorisë sipas ndryshimeve statutare
10. Pjesëmarrje aktive në komisione të ndryshme sipas kërkesave

### Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim

#### Projektet kapitale - investime kapitale

1. Mirëmbajtja verore e rrugëve” (kompania “TALI “,
2. Pastrimi i rrugëve mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave të gjelbërta” - kontraktues “Eco-Higjiena”
3. Sinjalizimi vertikal – horizontal, numërizimi i objekteve” - kontraktues “Viva – Print”
4. Sanimi i ndriçimit publik” në fshatrat e Komunës së Gjilanit. Kontraktues “Elektring” nga Ferizaj
5. Është kryer ndriçimi publik në gjitha fshatrat e është duke u vazhduar mirëmbajtja nga Kontraktori,
6. Sanimi i ndriçimit publik” në qytetin Gjilanit. Kontraktues “Viva Print” nga Gjilani.
7. Rrugët e rendit të tretë”- kontraktues “Bass Comm” nga Gjilani.
8. Mirëmbajtja dimërore e rrugëve 2014/15”. Janë zhvilluar dy ftesa për kuetim, ku kontraktues ka qenë kompania TALI. Kurse kontratën e rregullt e ka pasur operatori “Zuka” nga Gjilani.  
Drejtoria e SHPIB e ka dorëzuar projektin e Mirëmbajtjes Dimërore dhe Verore për shpallje të tenderit në zyrën e prokurimit për vitin 2015/2018

#### Projektet tjera - mallra dhe shërbime

1. Bartja e automjeteve me merimangë - Kontraktues “Auto Buli” Gjilan. Punët janë duke u zhvilluar sipas kontratës.

2. Ofrimi i shërbimit të varrimit - Kontraktues “Bereqeti” Gjilan. Punët janë realizuar sipas kontratës, mirëpo kontrata ka skaduar për momentin, është në zyrën e prokurimit në procedurë të lidhjes së kontratës

**Të hyrat dhe shpenzimet për janar-shtator**

Nr	Emërtimi i taksës	janar	shkurt	mars	prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator
1	Taksë rrugore (10 dhe 20) € ShP 9 01	9,390.00	9,840.00	13.950	16.810.0	15.910.00	15,770.00	17,390.0	15,610.0	14,220.00
2	Taksë për automjetin e tërhequr ShP 9 02	900.00	630.00	1430	1.045.00	2.085.00	2,920.00	2,900.0	1,961.0	2,170.0
3	Taksë për ndërhyrje në infrastrukturë ShP 9 03	00	00	2563	842.00	1.200.00	1,342.00	1,060.0	1,095.0	930.00
4	Taksë për shfrytëzimin e hapësirës publike ShP 9 04	2,436.00	3,873.50	7364.50	8864.5.	8.831.58	6,327.65	8,147.20	5,469.10	6,878.00
5	Taksë shitja e banesave në pronësi publike ShP9 05	0.00	0.00	352.00	/	/	00.00	00.000	00.00	00
6	Gjobat në trafik për /2015	32,291.0	20,132.0	18,131.0	19,836.0	18,497.0	19,414.0	23,210.0	22,612	/
7	Gjobat në trafik për mes gjyk.për 9/2015 të pa alokuara	/	/	/	/	/	/	/	/	/
<b>Gjithsejtë:</b>		<b>45,027.00</b>	<b>34,475.50</b>	<b>43,790.5</b>	<b>91,188.00</b>	<b>46,523.58</b>	<b>45,773.65</b>	<b>52,707.02</b>	<b>46,747.10</b>	<b>24,198.00</b>



## Shërbimet e varrimit

NR.	Muaji	Nr. i personave
1	Janar	62
2.	Shkurt	54
3.	Mars	78
4.	Prill	71
5.	Maj	52
6	Qershor +5 dit Korrik	70
7	Korrik	55
8	Gusht	36
9	shtator	55

## Autoparku-tërheqja dhe vendqëndrimi

Nr	Periudha e tërheqjes	Automjetet e tërhequra	Automjetet të liruara	Automjetet e Mbetura
1	Periudha para 2015			55
2	Janar – shtator 2015		507	Autoparku i komunës- 17 Autoparku i PK-së 18
	TOTALI	542	507	35

Automjetet në autoparkun e Komunës dhe në atë të Policisë së Kosovës kanë mbetur për shkak të proceduarve gjyqësore.

## Raporti i inspektimeve në komunikacion dhe shërbimeve publike

Nr.	Inspektimet në komunikacion dhe shërbime publike	
1	Inspektimet	757
2	Numri i procesverbaleve	268
3	Numri i kundërvajtjeve	41
4	Numri gjobave mandator	04
5	Numri i përjashtimeve nga komunikacioni	54
6	aksionet me Policinë e Kosovës	29
7	aksionet me Inspektoren e Ministrisë së Infrastrukturës	08
8	Numri reklamave të konfiskuara	15
9	Numri i kërkesave të pranuar	35
10	Numri i kërkesave të shqyrtuara	33
11	Numri i tendave të evidentuara para lokaleve afariste	08
12	Numri i reklamave të evidentuara	51

Obligimet që kanë ndaj Drejtorisë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim - Komunës së Gjilanit, sipas tarifave komunale për shfrytëzimin e hapësirës publike janë **9,332.75€** dhe pronës publike borxhet e lokaleve mbi qiranë, argjendarit dhe kioskat janë **53,616.00 €**.

## Lëndët në procedurë administrative

tabela:

Të miratuara	1119
Të refuzuara	0
Të pezulluara	1
Të hedhura poshtë	0
Në proces të shqyrtimit	47
Të pranuar gjithsej-zgjidhur	1157

### Projektet e realizuara nga kompanitë e kontraktuara

1. “Rrugët e rendit të tretë”- kontraktues “Bass Comm” nga Gjilani. Janë kryer disa rrugë në lagjet e qytetit si dhe diku rreth 52 rrugë nëpër fshatrat e komunës. Është bërë hapja, rrafshimi si dhe trasimi dhe shtruarja e rrugëve me zhavorr, gjithsej janë realizuar deri më tani 62,371 m’ ose 62km rrugë të shtruara . Punët janë duke u zhvilluar sipas dinamikës dhe kontratës.
2. Sanimi i rrugëve ka pasur pak vonesa për arsye të ankesave ndërmjet kompanive mirëpo me datën 09.06.2015 është shpallur kompania fituese SH.P.K “TALI. Kompania është duke i mbyllur me një dinamikë të përshpejtuar.
3. Janë sanuar komplet rrugët e qytetit diku rreth 14,353.85m<sup>2</sup>, kurse shtresa të rrugëve janë diku rreth 13,188.18 m<sup>2</sup>
4. Sanimi i ndriçimit publik” në qytetin Gjilanit. Kontraktues “Viva Print” nga Gjilani. (ndërrimi i poçave nga ato me shpenzime të larta, në poqa ekonomike)
  - a)= 442 copë TN (trupa ndriçues)
  - b) = 28.255 m` kablllo
  - c)= 250 ndërrim i poçave
5. Sanimi i ndriçimit publik” në fshatrat e Komunës së Gjilanit. Kontraktues “Elektring” nga Ferizaj.
6. Projekti i Sinjalizimit horizontal dhe vertikal në Komunën e Gjilanit, ekzekutues i punimeve firma N.SH. “ VIVA PRINT. Është vazhduar me sinjalizim vertikal sipas kërkesave në terren .

### Projekte të vogla:

Gjithsej kanalizim	601.00m'
Gjithsej kubëza	2751.43m <sup>2</sup>

### Sfidat

1. Shqetësuese kanë qenë reshjet e shumta të cilat kanë shkaktuar vërshime disa herë në qytet dhe fshatra. Vërshimet kanë ardhur si pasojë e gjendjes jo të mirë të shtretërve të lumenjve (hedhja e mbeturinave, devijimet, ndërtime pa kritere në brigjet e lumenjve), zënia e kanaleve anësore të rrugëve, ujëlëshesave, mungesa e kolektorëve kryesorë të rrjetit të kanalizimit fekal, mungesa e rrjetit të kanalizimit atmosferik etj. Kemi qenë vazhdimisht në kontakt me DMSH (drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim), KRU “Hidromorava” dhe të gjithë faktorët tjerë relevant në tejkalimin e kësaj gjendje.
2. Pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe mirëmbajtja vijave ujore dhe infrastrukturës përcjellëse të tyre mbetet prioritet;

3. Caktimi i lokacionit të ri të varrezave të qytetit, ju ka dërguar kërkesë urgjente (DUMM)
4. Ndërtimi i kolektorëve të ujërave fekale në qytet dhe fshatra duke përfshi edhe impiantin për trajtim të ujerave të zeza;
5. Zbatimi i planit të mobilitetit në trafik ;
6. Numri i madh i taksive me leje e posaçërisht i atyre pa leje;
7. Caktimi i lokacionit dhe rregullimi i tregut të kafshëve,
8. Caktimi i lokacionit dhe rregullimi i tregut të druve dhe rërës;
9. Ndërtimi i autoparkut- për vendosjen e makinave të aksidentuara dhe tjerat që tërhiqen për shkak të parkingut të gabuar, veprave penale ;
10. Për realizimin e kërkesave të qytetarëve, ngritjen e shkallës së ofrimit të shërbimeve ndaj tyre si dhe realizimin e gjitha projekteve që ka planifikuar DSHPIB-ja, kërkojmë që të ndahen mjete shtesë.

## Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë

Sipas planifikimeve, nga fillimi i muajit janar, i gjithë stafi i drejtorisë është angazhuar në ofrimin e shërbimeve, këshillave dhe trajnimeve për fermerë. Nga DBP, për periudhën nëntë mujore, janë trajnuar dhe kanë marr këshilla 902 fermerë, që paraqet angazhim maksimal të drejtorisë.

Për subvencionet që epen nga MBPZHR kanë aplikuar **914** fermerë ose **127** fermerë më shumë se vitin e kaluar dhe ka rritje substanciale të sipërfaqeve dhe numrit të krerëve nga vitet e kaluara. Këtë vit kemi rritje për **720 ha** te kultura e grurit, **108 ha** te kultura e misrit, rritje të numrit të krerëve për lopë qumështore për **400 krerë**, kemi rritje të shoqërive të bletëve **795 shoqëri**. Politika që përmes subvencioneve komunale, të rritet numri i fermerëve që i plotësojnë kriteret e Ministrisë është treguar plotësisht efektive.

Investimet këtë vit i kemi nisur me projektin e atomizerve dhe me datën 24.02.2015, kemi shpërndarë 15 atomizer për spërkatjen e pemëve. Përfitues kanë qenë bujqit që kultivojnë mbi 0.50 ha pemishte dhe nuk posedojnë një mekanizëm të tillë. Vlera e këtij investime ka qenë **16,500.00 €**.

Në bashkëpunim me Care International implementues i projektit rajonal të Komisionit Evropian, kemi filluar implementimin. Kemi bërë ftesën për aplikim, kemi udhëhequr të gjitha procedurat dhe nga 30 fermerë përfitues të mundshëm në rajon, nga komuna jonë janë përzgjedhur 15 përfitues:

1. kultivuesve për sallatë të gjelbër dhe serra me 500 m<sup>2</sup>.
2. kultivuesve për bimë mjekësore dhe aromatike dhe
3. përfituesve të tharëseve për bimë mjekësore, aromatike, kërpudha dhe fruta të pa kultivuara malore.

Vlera e këtij projekti mbi **100,000.00 €**.

Me datën 10.02.2015, në bashkëpunim me Tikën Turke, kemi nisur përgatitjen për implementimin e projektit për furnizimin e 155 bletarëve me pajisje: rroba për bletar, dorëza pune, aparat për tymosje, qelës për nxjerrjen e kornizave, kurth poleni, sita, aparat elektrik për ngjitjen e hojeve dhe pirun. Gjithashtu me këtë projekt janë përfshirë edhe 40 lavërtarë, të cilët kanë përfituar 40 shpërndarëse të plehut. Drejtoria e Bujqësisë ka udhëhequr procedurat dhe ka përzgjedhur fermerët përfitues.

Vlera e këtij projekti kap shumën prej **25,000.00 €** dhe ishte donacion i TIK-ës.

Me datën 03.03.2015, në kuadër të projektit për subvencionim të farës së misrit dhe plehut artificial, kemi publikuar ftesën për aplikim në zyrën për shërbim me qytetarë. Nga kjo zyrë kemi pranuar 598 aplikacione. Ky projekt është realizuar me datën 28.04.2015, ku përfitues kanë qenë 583 fermerë. Vlera e projektit **33,000.00 €**.

Nga data 18.06.2015 kemi filluar implementimin e projektit të rrugëve fushore dhe për këtë vit kemi planifikuar trajtimin e rreth 20 km rrugë të arave. Deri tani kemi përfunduar: 4.5 km rrugë në fshatin

Zhegër, 1.4 km në Nasalë, 1.0 në Lladovë, 3.7 km në Cërrnicë dhe 6.4 km në fshatin Përlepnice. Jemi duke vazhduar me punime dhe shpresojmë t'i përfundojmë edhe rrugët në Livoq të Epërm, Kravaricë, Livoq i Ulët dhe Gumnishë. Vlera e këtij investimi është **105,000.00 €**.

Kemi nisur procedurat për furnizimin e 10 fermerëve, kultivues të lopëve qumështore me Llaktofrizë 350 litërsh. Ky projekt do të realizohet nga Komuna në bashkëpunim me Qumështoren KABI dhe me participim edhe të fermerëve përfitues. Projekti është duke u implementuar dhe vlera e këtij projekti është **20,000.00 €**.

Jemi në pritje për implementim e projektit për furnizim të bujqve me farë gruri. Deri tani kemi pranuar 857 aplikacione. Vlera e këtij projekti është **53,000.00 €**.

Gjithashtu, jemi duke pranuar aplikacionet për furnizim të fermerëve me mekanizim bujqësor: 30 Spërkatëse, 10 Rotofrezë, 10 Piatore, 10 Kositëse rotative dhe 10 Grumbulluese të sanës. Vlera e këtij projekti do të jetë **52,500.00 €**.

Kemi iniciuar procedurat tenderuese, për gjetjen e Kompanisë (operatorit ekonomik) që do të bëjë furnizimin dhe montimin e konstruksioneve metalike për serra komerciale.

Në projekt është paraparë ndërtimi i njëzet (20) serrave:

1. dhjetë (10) serra me sipërfaqe nga 300 m<sup>2</sup>, si dhe
2. dhjetë (10) serra me sipërfaqe nga 150 m<sup>2</sup>.

Tipi i serrës : Tunel

1. Ndërtimi dhe montimi i konstruksionit të dyfishtë metalik të serrave.
2. Dimensionet e serrës prej 300 m<sup>2</sup> janë: 43 m gjatësi x 7 m gjerësi x 3.5 m lartësi.
3. Dimensionet e serrës prej 150 m<sup>2</sup> janë: 21.5 m gjatësi x 7 m gjerësi x 3.5 m lartësi

Vlera e këtij projekti është **30,000.00 €**.

Në sektorin e Pylltarisë nga data 01.01.2015 deri me 30.09.2015 kemi pasur 447 kërkesa të parashtruara për prerje të masës drusore në pyjet private.

Gjatë kësaj periudhe kemi ngritur 253 fletëparaqitje, prej të cilave 166 për kundërvajtje, 48 penale dhe 39 për transport.

Për këtë periudhë gjashtë mujore kemi pasur 20 raste të konfiskimit të druve në sasi prej 47.73m<sup>3</sup>.

Në bazë të planifikimeve vjetore të shfrytëzimit- prerjes së masës drusore për vitin 2015 nga ana e Agjencionit Pyjor të Kosovës, Drejtoria koordinuese e APK-së në Gjilan ka bërë Planifikimin, damkosjen dhe vlerësimin e masës drusore në këto ngastra:

Komuna	Njësia menaxhuese	Ngastra nr.	Sasia bruto ( m <sup>3</sup> )
Gjilan	Zhegocë	21	1.138.70
Gjilan	Zhegocë	29	620.00
Gjilan	Zhegocë- Kishnapole	60	1.332.00

Për secilën ngastër është bërë vlerësimi detal nga Agjencionin Pyjor i Kosovës – Drejtoria Koordinuese në Gjilan me nr. të Referencës: 245/15, 246/15 dhe 247/15, të datës 01.06.2015. Të tri këto ngastra janë në përfundim e sipër.

Sektori i Inspeksionit për Bujqësi dhe Veterinari, gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore ka kryer këto vizita inspektuese:

Lloji i kontrollit	Numri
Kontrollime	226
Procesverbale	133
Pranime teknike të lokaleve - Ordinancave dhe barnatoreve	48
Therje të kafshëve	842
Transport të kafshëve të gjalla	677
Dënime	2
Vendime për gjykatë	2
Përgjigje kërkesave të qytetarëve	14
Asistencë zyrës regjionale të AUV	37

Përveç punëve të paraqitura në tabela, inspeksioni ka monitoruar kompaninë gjatë kryerjes së DDD në hapësirat shkollore, me urdhëresë të AUV është bërë tërheqja nga shitja e qumështit të foshnjave „ Aptamil ”, si dhe punë të tjera rutinë si monitorimi i kontrollit të ligjit të duhanit, kontrolli i afateve të produkteve ushqimore, mangësitë gjatë procesit teknologjik të produkteve ushqimore etj.

## Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Gjatë kësaj periudhe nëntë mujore, në DGJKP janë pranuar gjithsej **4690 lëndë- kërkesa** të ndryshme të qytetarëve dhe të personave juridik. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, numri i lëndëve është rritur për **245** sosh.

Nr.	Sektori	Lëndë të pranuar	Lëndë të kryera	Lëndë në procedurë
1.	Sektori i Kadastrit	2367	2120	247
2.	Sektori i Gjeodezisë	1174	1128	46
3.	Sektori i Pronës	1149	1116	33
	Gjithsejtë:	4690	4364	326

Përveç kërkesave të paraqitura në tabelë, DGJKP, ka kryer edhe punë dhe aktivitete tjera sipas detyrës zyrtare si dhe me kërkesa të Drejtorive Komunale, si në vijim :

1. Personat fizik dhe juridik si dhe institucionet e ndryshme, në DGJKP janë pajisur me dokumentacion si në

Tabela: 1.

Nr.	PRODUKTI	SASIA
1.	Certifikata të pronës / fleta poseduese	9427
2.	Kopje të planit	1531
3.	Koordinata të ngastrave	774
4.	Certifikata të gjendjes ekonomike	1628
	Gjithsejtë :	<b>13360</b>

2. Sa i përket procedurave të shpronësimit, në këtë periudhë të vitit 2015, sipas Vendimeve Përfundimtare për nevoja të shpronësimit janë paguar **195.299,17 €** dhe janë në procedurë të regjistrimit 16 ngastra kadastrale nga pronarët privat në emër të komunës.
3. Janë kryer shërbime të rindërtimit të të dhënave kadastrale dhe të matjeve për projekte zhvillimore,

4. Duke u bazuar në përgjegjësit e Drejtorisë, DGJKP-ja sipas detyrës zyrtare ka ndërmarr aksionin e rievimit të objekteve komunale në tërë territorin e Komunës së Gjilanit. Rievimi është duke u kryer sipas zonave kadastrale duke filluar nga zonat më të largëta e duke vazhduar në zonën kadastrale të qytetit.

Deri më tani janë kryer matjet në këto Zona kadastrale, siç janë:

Tabela: 2.

Nr.	Zona Kadastrale	Lloji i objektit	Lloji i objektit	Lloji i objektit	Lloji i objektit
1.	Bilinicë	Shkolla fillore			
2.	Stublinë	Shkolla fillore			
3.	Inatoc-Kokaj	Shkolla fillore			
4.	Sllubicë	Shkolla fillore			
5.	Pogragjë	Shkolla fillore	Zyra e vendit	Ambulanca	Fusha sportive
6.	Llovcë	Shkolla fillore			
7.	Uglarë	Shkolla fillore		Ambulanca	
8.	Bukovik-Capar	Shkolla fillore			
9.	Malishevë	Shkolla fillore	Zyra e vendit	Ambulanca	
10.	Stançiq	Nuk ka objekt	Nuk ka objekt	Nuk ka objekt	Nuk ka objekt
11.	Shurdhan	Shkolla në ndërtim	Zyra e vendit		
12.	Dunav	Objekti i shkollës jashtë përdorimit			
13.	Pidiq	Objekti i shkollës jashtë përdorimit			
14.	Haxhaj	Shkolla fillore			
15.	Selishtë	Shkolla fillore			
16.	Zhegër	Shkolla fillore e re			

Ky aktivitet është në proces dhe vazhdon në muajt e ardhshëm me zonat tjera kadastrale të Komunës së Gjilanit

DGJKP-ja, gjatë kryerjes së këtyre punëve, ka krijuar edhe të hyra financiare të cilat në këtë periudhë 9 mujore kapin shumën prej **144.864,00 €**.

## Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Aktivitetet e DMSH gjatë kësaj periudhe raportuese:

1. Bashkëpunimi me DSHP karakterizohet në aksione të përbashkëta në përballje me fatkeqësitë që e goditën komunën, siç ishin reshjet e borës dhe eliminimi i rrezikut nga pasojat e vërshimeve dhe aktivitete tjera të cilat kanë qenë në interes të qytetarëve të Komunës së Gjilanit. Gjatë kësaj periudhe me aktivitet të përbashkët janë identifikuar vendet ku duhet intervenuar për eliminimin e pengesave të cilat i kanë shkaktuar vërshimet;
2. Bashkëpunimi dhe aktiviteti i përbashkët është zhvilluar edhe me ndërmarrjen publike “Hidromorava”, Bashkëpunimi me Drejtorinë e Arsimit në këtë vit ka filluar një aktivitet intensiv i cili në të kaluarën ka munguar, qëllimi i të cilit aktivitet është njoftimi dhe aftësimi i nxënësve dhe arsimtarëve me përballjen e pasojave nga zjarri,
3. Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, veçanërisht gjatë vërshimeve që në këtë vit dy herë goditën komunën dhe në kohën verore të pritjes së bashkatdhetarëve dhe gjatë intervenimeve në shuarjen e zjarreve fushore dhe malore, angazhimi në identifikimin e familjeve në nevojë për banim social, angazhimi në Komisionin për vlerësimin e dëmeve nga të reshurat atmosferike, angazhimi në dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizim (DDD) të objekteve dhe hapësirave publike, strehimi i familjeve nga Kumanova, si dhe vlerësimin për gjendjen e sigurisë fizike të objekteve të komunës dhe propozimin për kapacitetet e nevojshme të ruajtjes;
4. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, me qëllim të pajisjes së shërbimit të SHZSH me mjete pune për intervenim, ka arritur që përmes bashkëqytetarëve që punojnë në Zvicër, të pajiset me disa mjete elementare (një automjet komandues, pompa për thithjen e ujit) si dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme me një automjet profesional për fikjen e zjarreve fushore edhe me një automjet sulmues, mjete këto të cilat ngritin kapacitetet intervenuese, si dhe sigurojnë intervenime efikase dhe cilësore.
5. Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, në vazhdimësi, por edhe në këtë nëntëmujor vazhdon të identifikoi objektet të vjetra të cilat paraqesin rrezik për qytetarët.

Në krahasim me vitet paraprake, kjo periudhë raportuese karakterizohet si më e qetë, sa i përket përhapjes së zjarreve fushore dhe malore, gjë që rezulton se kjo ka ardhur si shkak i ndikimit të drejtorisë në vetëdijësimin e popullatës përmes mjeteve të informimit, përmes afisheve të vendosura nëpër vendbanimet e komunës si dhe duke ngritur kapacitetet intervenuese të SHZSH me blerje të shërbimeve nga shoqata e zjarrfikësve vullnetarë.

**Tabela: Inspektorët e preventivës:**

Inspektimet e		Sektori i Pasurisë			Numri i objekteve të inspektuara sipas kategorisë					Nr. i masave të propozuara	Nr. i aktvendimeve të marrura	Nr. i masave të urdhëruara	Nr. i pëlqimeve në dok. Investivo-teknik	Nr. i vendshiqimeve të zjarrit	Nr. i raporteve mbi zjarrin	Nr. i vërtetimeve mbi zjarrin
Rregullta	Gjithsejtë	Shoqërorë	Privat	Gjithsejtë	I	II	III	IV	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë	Gjithsejtë
72	72	24	48	72	16	37	19	-	72	287	4	14	15	22	22	13

**Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi**

KKSB, ka aprovuar planin e punës për vitin 2015, ku në këtë plan janë përfshirë detyrat konkrete të sigurisë, të afirmimit të marrëdhënieve ndëretnike, bashkëpunimit dhe tolerancës ndër fetare, detyrat e organeve në luftë kundër dukurive negative, sigurisë në komunikacion, lëvizjes së lirë si dhe aktiviteteve të ndryshme që kërkon momenti politik në komunë. Fenomeni i emigrimit të paligjshëm masiv të qytetarëve në vendet perëndimore, organizimi i takimeve me krerët fetarë si Islam Ortodoks, Katolik, Protestantë, këto takime kanë qenë mujore, janë mbajtur në çdo bashkësi fetare, organizimin dhe shpalljes së muajit Tetor, si muaj të tolerancës ndër fetare i cili u shënuar me aktivitetin e tij të parë, pastrimin e oborrit të Xhamisë dhe kishës katolike në fshatin Dunav.

Rendi dhe qetësia publike ka qenë teme diskutimi në të gjitha takimet e KKSB, bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, me FSK-në, me organet tjera komunale, me organizatat joqeveritare dhe organet e emergjencave.

**Drejtoria për Zhvillim Ekonomik**

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik gjatë muajit janar – shtator 2015, ka vazhduar me aktivitete të cilat kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të zhvillimit ekonomik lokal në komunë, e gjitha duke përkrahur biznese të vogla e të mesme që të aplikojnë në thirrjet për grante, gjë që po rezulton me sukses .

Gjatë kësaj periudhe fokus i veçantë iu është kushtuar bashkëpunimit me komunitetin ndërkombëtar (donatorët) dhe Qeverinë e Kosovës (ministrit e linjës), po ashtu rëndësi të madhe i kemi kushtuar edhe bashkëpunimit me drejtoritë komunale.

Aktivitetet të cilat janë realizuar gjatë kësaj periudhe:

1. Me kërkesë të Shërbimit të Kuvendit kemi përgatitur dhe ju kemi dorëzuar grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës të Kuvendit të Komunës së Gjilanit për vitin 2015 .
2. Zyra për Eficiencë të Energjisë e cila në bashkëpunim dhe në mbështetje të Asociacionit të Komunave të Kosovës kanë nënshkruar Marrëveshje të Mirëkuptimit për financimin e aktiviteteve në vlerën prej 40.000€ për implementimin e Strategjisë për Energji, programi EeMA (që financohet nga GIZ dhe SDC). Pas projektit të fituar muaj më parë për implementimin e eficiencës së



energjisë, përkatësisht për hartimin e SEAP, **Komuna e Gjilanit është pranuar në Konventën e kryetarëve të Komunave** në Bruksel. Pranimin në këtë Konventë do ta nënshkruaj kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri më 15 tetor 2015 në konferencën vjetore të BE-së për një Evropë me energji të qëndrueshme.

3. Drejtorja për Zhvillim Ekonomik në saxe të bashkëpunimit ka fuqizuar marrëdhëniet me Ministrinë e Financave të Kosovës dhe Ministrinë e Financave të Austrisë, ku ka aplikuar në programin (Soft Loan Project) i cili program i dedikohet projekteve madhore që përfshin infrastrukturën publike me fokus të veçantë rrjete të kanalizimit dhe trajtim të ujërave të zeza. Vlera totale e projektit është rreth 7.4 milion euro dhe pritet që deri në fund të vitit 2015 të nënshkruhet marrëveshja.
4. Është punuar ngushtë me Agjencinë për Zhvillim Rajonal (RDA), Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) dhe Ministrinë e Integritimit Evropian, për organizimin e konferencës së donatorëve e cila është mbajtur me 4 mars ku 11 komuna të regjionit lindje i ka paraqitur komunitetit ndërkombëtar projektet e tyre, konferenca është mbështetur nga zyra e BE-së në Kosovës.
5. Drejtorja për Zhvillim Ekonomik po e njofton dhe po e ndihmon komitetin e biznesit, grupet e nxënësve dhe studentëve, organizatat e shoqërisë civile si dhe grupet tjera të interesit për aplikim në programet për grante të cilat po afrohen nga organizatat ndërkombëtare, përmes këtyre programeve:
  - a) Programin Empower Sektori Privat që financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Cardno Emerging Markets USA, Ltd. (Cardno). EMPOWER Sektori Privat bashkë me Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë dhe Komunën e Gjilanit kanë siguruar një hapësirë të shkëlqyeshme në panair për kompanitë kosovare.
  - b) Programi Community Development Fund, partner implementues i programit të USAID-it "Avancojmë Kosovën së Bashku - Alternativa Lokale (AKT-LS)" në Kosovë i cili i dedikohet punësimit dhe zhvillimit ekonomik.
  - c) Programi i Vetëpunësimit - Ky program do të implementohet me mbështetjen e projektit të UNDP Programet aktive të tregut të punës 2, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës, UNDP dhe Qeveria e Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), komuna partnere të këtij programi janë: Gjilani, Prishtina dhe Prizreni.
  - d) Programi KYDP (Kosovo Youth Development Projekct) - Projekti për Zhvillimin Rinor në Kosovë i cili ofron trajnim falas për ndërmarrësit e rinj. Projekti është financuar nga Banka Botërore dhe ka për qëllim përkrahjen e të rinjve në biznes nëpërmes trajnimeve dhe granteve. Projekti financohet nga Banka Botërore dhe implementohet nga organizata "Qendra Rinore" Gjilan. Drejtorja për Zhvillim Ekonomik do të siguroj shtatë zyre brenda hapësirës së Inkubatorit të Biznesit, për bizneset e reja të cilat përfitojnë nga ky grant.
  - e) PPSE (Promoting Private Sector Employment) – sektorët në të cilët do të mbështetën nga ky janë: Sektori i turizmit dhe Përpunimit të ushqimit. Fondi i mundësive është mekanizëm grantesh në përkrahje të krijimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të punësimit në sektorin privat për të rinjtë. Do të përkrah financiarisht konceptet e projekteve nga 10.000 € minimum e deri në 100.000 € maksimum, aplikuesit duhet të sigurojnë fondet vetanake nga 20-50% të vlerës totale të projektit.
6. Drejtorja për Zhvillim Ekonomik, është duke bashkëpunuar ngushtë edhe me organizatën GIZ dhe në Hartimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, po ashtu në kuadër të aktiviteteve kemi aplikuar edhe me projekte të cilat e ndihmojnë sektorin e trajtimit të mbeturinave:

- a) Pilot Projekti “Gjilani Riciklon” ku përfshihet trajnimi i mbeturinave në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të qytetit dhe institucionet komunale projekti implementohet nga organizata Green Art Ceneter – Prishtina .
  - b) Pilot projekti “Dardania” e cila përfshin trajtimin dhe ndarjen e mbeturinave, tani kemi marrëveshje me kompania ”Schafer” që ka shprehur gatishmëri që ta implementoj këtë pilot projekt, ku do të financoj kontejnerë të kapacitetit 240 litra për lagjen “Dardania” dhe të kapacitetit 1.1 m3, që kapin vlerën e afro 50 mijë eurosh, derisa Komuna participon me shumën prej 5 mijë eurosh.
7. Po ashtu nuk ka munguar edhe bashkëpunimi me TIK-në Turke, e cila ka aprovuar projektin që është dorëzuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik që ka të bëjë me furnizimin e 155 bletarëve të Komunës së Gjilanit me rroba dhe pajisje tjetër për bletarë si dhe pajisjen e 40 fermerëve me mekanizëm bujqësor (shpërndarëse gruri).
  8. Dy programet e Komisionit Evropian tani më janë kompletuar me staf dhe janë në fazën intensive të realizimit – fjala është për programet:
    - a) Programi BE – BNK Bashkëpunimi Ndërkufitarë Komuna e Gjilanit (KS) & Komuna e Çairit (MK) e cila implementohet edhe në bashkëpunim me dy organizata jo qeveritare Organizata AgorEko (Gjilan) dhe Initiative for European Perspective (Çair), emri i projektit: Valorizimi i tregtisë tradicionale dhe potenciali socio-ekonomik)
    - b) Programi BE – EURED, emri i programit: Zhvillimi i Agrobizneseve në Regjionin e Gjilanit, që po realizohet nga Organizata CARE dhe ATRC dhe
    - c) Programi Kosova e Bukur faza II / EU-BEAUTIFUL KOSOVO PROGRAMME (EU-BK II) ku është aprovuar projekti “Ndërtimi i parkut të qytetit në lagjen Dardania” i cili është në realizim e sipër dhe pritet të përfundoj gjatë muajit nëntor 2015.
  9. Help – Hilfe zur Selbsthilfe E.V – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, ka aplikuar dhe është aprovuar projekti “Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik përmes fuqizimit të mikro-bizneseve në Kosovë” i cili do të bashkë-financohet në bashkëpunim me Organizata Help, projekti do të filloj zbatohet në muajin janar 2016 dhe te përfundoj në dhjetor 2016, ku do të shpërndahen 40 grante në komunën tuaj, ndërsa Marrëveshja e bashkëpunimit do të nënshkruhet gjatë muajit tetor 2015.
  10. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ka marrë pjesë edhe në panairin e Cyrihut i cili është dedikuar projekteve madhore në infrastrukturë dhe krijimin e vendeve të lira të punës, panair është mbajtur nga data 19-21 maj të vitit 2015. Komuna e Gjilanit në panairin ndërkombëtar "Investment Management Exhibition" ka marrë çmimin “The best City Model Award" nga IME.
  11. Panairi Regjional “Gjilani 2015” – i cili është mbajtur me datë 2, 3 dhe 4 korrik, ku kanë marrë pjesë afërsisht 100 biznese, të regjionit Lindje. Panairi Regjional “Gjilani 2015” ka shërbyer si mundësi për promovimin e prodhimeve lokale në nivel regjional, ky aktivitet do të jete një rast i mirë në këmbimin e përvojave dhe të promovimit të brendeve lokale në nivel regjional si dhe të bashkatdhetarët tanë që në këtë periudhe kohore gjendeshin për pushime.
  12. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik pas Panairit Regjional “Gjilani 2015” ka organizuar edhe aktivitetin e radhës “Ditët e Mërgatës” i cili është mbajtur me 30, 31 korrik dhe 1 gusht 2015, po ashtu gjatë kësaj kohe janë organizuar edhe aktivitet të shumta për nderë të mërgatës si dhe aktivitet të shumta “Ditët e Vendeve Mike” si dita e Japonisë, Amerikës, Gjermanisë, Francës, Turqisë dhe Austrisë.
  13. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik është duke koordinuar aktivitet edhe me Organizatën Qeveritare Gjermane Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit – GIZ, e cila po fillon

implementimin e projektit “Promovimi dhe konkurrueshmërisë së sektorit privat në zonat rurale - COSiRA” të financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik - BMZ. Projekti i GIZ COSiRA "Konkurrueshmëria e sektorit privat në zonat rurale", përfshin institucionet private dhe publike në nivel lokal në identifikimin e avantazheve krahasuese rajonale.

14. Partneriteti Publiko Privat: Projektit “Kompleksi i shkollave të mesme” tani është në fazën e tenderimit dhe pritet që gjatë muajit tetor – nëntor të përmbyllet ky proces. Tani jemi në fazën për përgatitjen e studimit të fizibilitetit për projektet:

- a) Palestra sportive “Bashkim Selishta” dhe
- b) Objektet përcjellëse (stalla e lopëve, sera, plantacioni, depoja ftohëse për pemë dhe perime) të shkollës së mesme bujqësore “Arbëria.

15. Në vazhden e aktiviteteve të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, jemi takuar edhe me përfaqësuesin e “D&D – Business Support Center”, të cilët janë duke e implementuar projektin e Bankës Botërore për Zhvillimin e Rinisë në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij projekti është përmirësimi i mundësive ekonomike dhe qasja e qëndrueshme në shërbime për të rinjtë e Kosovës por edhe promovimi i kohezionit social si dhe bashkëpunimi shumë etnik midis të rinjve, e sidomos për grupet e anashkaluara dhe të pambrojtura.

16. Drejtorja e Zhvillimit ekonomik ka krijuar ura bashkëpunimi edhe me përfaqësuesit e Odës Ekonomike Gjermano - Kosovare, qëllimi i takimit ishte bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve të përbashkëta të cilat do të ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Komunës së Gjilanit. Kërkesë e Odës Ekonomike Gjermano Kosovare, ishte vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve për punë profesionale, sepse kjo është edhe një prej kërkesave të vendeve të huaja për resurse njerëzore me shkolla profesionale.

#### Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QRB)

Qendra për Regjistrim të Bizneseve (QRB) në Gjilan gjatë periudhës janar – shtator 2015, ka kryer aktivitetet e saja sa i përket kërkesave të qytetarëve për regjistrim të bizneseve dhe komunitetit të biznesit, për ndërrim dhe shtim të aktiviteteve biznesore apo edhe shuarje të biznesit.

1. Regjistrimi i bizneseve të reja 403
2. Shuarje të biznesit 80
3. Informata 76
4. Ndryshime në biznes(Certifikatë të biznesit) 246
5. Certifikata të reja (ndërrime nga certifikata e UNMIK-ut) 68
6. Vërtetime për mos posedim të biznesit 4
7. Punëtore të deklaruar në regjistrimin e bizneseve të reja 660

Sipas Qendrës për Regjistrim të Bizneseve (QRB) në Gjilan, gjatë periudhës janar – shtator 2015 kemi të regjistruar sipas gjinisë:

- a) Biznese me pronar femra: 81
- b) Biznese me pronar meshkuj: 322

## Inspeksioni i Tregut

Sektori i Inspeksionit gjatë periudhës janar – shtator -2015, ka inspektuar bizneset që nuk janë të regjistruara po ashtu ka njoftuar komunitetin e biznesit për rregulloret komunale (orari i punës) dhe (taksa komunale). Gjatë kësaj periudhe ka kryer këto aktivitete në terren:

1. Procese të hartuara në terren 234
2. Pranime teknike të lokaleve afariste 177
3. Kërkesa për largim të mallit 3
4. Vërejtje për pranime teknike të lokaleve afariste 75
5. Njoftime dhe vërejtje për orar të punës 110
6. Lokale të mbyllura 7
7. Gjobat mandatore 3
8. Përgjigje në kërkesa 35
9. Vërejte për alkool dhe cigare 34
10. Lëndë për Gjykatë 4
11. Të hyra nga pranimet teknike 8,690 €
12. Të hyra nga gjobat mandatore 500 €

## Sektori i taksës komunale

Sektori i taksës komunale (analistët e bizneseve) gjatë periudhës janar – shtator 2015 në përputhje me vendimin komunal të Rregullores Komunale (Rregulloren për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale) ka kryer këto aktivitete në terren:

1. Procesverbale 317
2. Aktvendime 306
3. Vizita 317
4. Vërejtje 20
5. Vërejtje për pagesë bizneseve të lojërave të fatit në afat 1 muaj 35

Planifikimi dhe realizimi i të hyrave nga taksat komunale:

1. Të planifikuara për 2015: 150,000.00 euro
2. Të realizuara deri në shtator 2015: 73,213.06 euro apo 31.15%

## Sektori i financave

Deri më tani janë kryer këto aktivitete :

Vendime të përgatitura dhe të lëshuara për biznese në përputhje me rregulloren 280 në vlerë 109,940€

Deri më tani kemi ekzekutuar në përputhje me rregulloret dhe ligjet në fuqi:

1. Investimet kapitale:..... 519.690 €
2. Mallra dhe shërbime:..... 38.432 €
3. Komunali:..... 1.586€
4. Donacionet:..... 85.646,51€  
(ura në fshatin Pogragjë, projekti i Bashkëpunimit Ndërkufitar Gjilan-Çair)
5. Subvencione:..... 35,000 €
6. Shpronësim:..... 41,217 €

## II. AKTIVITETET E ZYRAVE DHE NJËSIVE

### Njësia e Kuvendit

Bazuar në Planin e punës, Janar-Shtator 2015, janë mbajtur takimet e Kuvendit, Komiteteve dhe Komisioneve tjera të KK-së, si në tabelën në vijim:

N.ren.	Kuvendi dhe trupat punuese	Numri i takimeve	Vendimet	Rekomandimet	Kërkesat
1	Kuvendi i Komunës	7+1 sol.	58	2	
2	Kom. për Politikë dhe Financa	8		57	
3	Komiteti për Shëndetësi dhe MS	9		6	
4	Komiteti për Komunitete	6		1	
5	Komiteti për Planifikim Urban	5		4	
6	Komiteti për Shërbime Publike	4		3	
7	Komiteti për Arsim	9		5	
8	Kom për Pron, Kadastër, Banim	7		8	
9	Komiteti për KRS	4		4	
10	Komiteti për Zhvillim Ekonomik	5		4	
11	Komiteti për Barazi Gjinore	3			
12	Komiteti për Bashk. ndërkufitarë	2		2	
13	Komisioni për emërtimin e rrugëve	15			
14	KKSB	4			
15	Debate për Buxhet	5			
16	Debate për Rregullore	6			

### Njësia e Personelit

#### Aktivitetet e Njesisë së Personelit

Nr.	Aktivitetet e kryera	Gjithsej
1.	Akt emërimi	32
2.	Kontrata në vepër	245
3.	Deklarata nën betim	216
4.	Vendime për përvojë të punës	301
5.	Vendime të ndryshme	121
6.	Aktvendime të pushimit vjetor	298
7.	Vërtetime të ndryshme	103
8.	Pushime mjekësore	8
9.	Akte përcjellëse	29
10.	Raporte	10
11.	Seanca të komisioneve	14
12.	Shkresa të ndryshme	108
13.	Formularë të ndryshëm (për ndryshime, retroaktive, punëtorë të rinj, të larguar, ndërrim të bankave, për kredi)	79
14.	Konsultime	27
15.	Aktivitete të ndryshme (kontratat për pagesë, dërgimi i listave të pagave etj.)	23
Gjithsejtë:		1614

## **Njësia për të Drejtat e Njeriut**

1. Është mekanizëm përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin komunal.
2. Monitoron zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut në fushat: për të drejtat e fëmijëve, barazia gjinore, të drejtat e komuniteteve, të personave me aftësi të kufizuara, përdorimin e gjuhëve, kundër diskriminimit, kundër trafikimit me qenie njerëzore e të tjera.
3. Monitoron seancat e KK, dhe të Komiteteve
4. Organizon dhe merr pjesë në debate e takime me Organizata Vendore dhe Ndërkombëtare të cilat merren me të drejtat e njeriut.
5. Grumbullon dhe plotëson Pyetësorët e MAPL-së me aktivitetet komunale që kanë të bëjnë me avancimin e të drejtave të njeriut.
6. Më 8 Mars është shënuar Dita Ndërkombëtare e Gruas me projektin: "Nëna është shtyllë e familjes",
7. Më 15 Maj, "Dita e Familjes" është realizuar Projekti "Pasuria është pronë e dy bashkëshortëve".

Janë organizuar debate nëpër vendet rurale me temë: "Të drejtat e njeriut", " Të Drejtat e Fëmijëve", "Barazia Gjinore", "Dhuna në Familje" "Trashëgimia" e të tjera.

Është shënuar 1 Qershori, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve.

Është realizuar projekti para Teatrit të qytetit me fëmijët e shkollave fillore të komuniteteve që jetojnë në komunën e Gjilanit. Është vendosur një Pano me titull: "Fëmijët janë pjesë e familjes dhe e shoqërisë" me moton "Arsimimi dhe edukimi i fëmijëve është themeli i një shteti". Është shpërndarë fletëpalosja me titull: "Jeta dhe Fëmijët".

## **Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport.**

Ne fillim të vitit kalendarikë kanë vazhduar angazhimet në kuadër të shënimit të shtatëdhjetë vjetorit të shënimit të masakrës së Gjilanit 1944/45, duke krijuar sensibilizimin e opinionit dhe te institucioneve gjegjëse në angazhimin dhe fillimin e zbardhjes së kësaj ngjarje të dhimbshme historike, duke u nderuar për sakrificën dhe heroizmin nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me urdhër nderi të lirisë si Institucioni i Komunës po ashtu edhe Hero të Gjilanit, që deri më tani nuk kanë qenë të vlerësuar për kontributin dhe sakrificën për liri dhe çlirim.

Paralelisht kane vazhduar përgatitjet për të organizuar edicionin e 24-të të Flakës së Janarit 2015, në këtë vit është përkujtuar edhe shtatëdhjetë vjetori i masakrës së Gjilanit 1944/45. Manifestimi është zhvilluar në shtyllat kryesore të artit me të cilat përmes aktiviteteve kulturore janë nderuar të gjithë të rënë nga koha e Skënderbeut e deri në ditët e sotme .

Manifestimi "Flaka e Janarit", për këto vite të zhvillimit ka arritur që të jetë njëra ndër ngjarjet më masive dhe më me vlera artistike, që mbledh rreth vetes me mijëra krijues të të gjitha zhanreve të artit duke përfshirë artistë/e dhe pjesëmarrës/e nga të gjitha trevat shqiptare.

Mendojmë se komuna e vetme nuk mund të përballojë shpenzimet e një manifestimi me përmasa mbarëkombëtare dhe me prurje kaq të mëdha, andaj synimi ynë është që të punojmë dhe angazhohemi që të përfshihet në kalendarin kulturor te MKRS-se.

## **Kremtimi i shtatë vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës**

Manifestimin e **17 shkurtit 2008**, këtë vit e begatoi edhe koncerti i drejtpërdrejtë "live" nga artistë dhe performues të shkollës së muzikës si **koncert festiv**, koncerti i madh me performues e artiste nga ansamblet e Komunës së Gjilanit si **koncerti artistik i mbrëmjes** dhe grupeve muzikore të qytetit që performuan në **koncertin rinor promovues**, me një pjesëmarrje të numrit të madh të qytetarëve dhe me një angazhim vullnetar të të gjithë sektorëve .

Për të përkujtuar të rënët për lirinë e atdheut, dhe për të nderuar veprën e tyre u organizuan homazhe në varrezat e dëshmorëve nga institucionet gjegjëse dhe qytetarët.

Gjithashtu, është organizuar ekspozita e përbashkët me arkivin ndërkomunal të Gjilanit, me punimet për përkujtimin e demonstratave të vitit 1989/90.

Aktivitete tjera si:

1. Akademi përkujtimore, shfaqje të filmave dokumentare kushtuar veprimtareve të ndryshme: konferenca shkencore, koncerte të performuesëve të ndryshëm kulturor, festa e mësuesit etj.
2. Festivali ditët e Lirisë së Gjilanit-2015, me shume aktivitetet sportive dhe kulturore përfshirë edhe Festivalin Gurra popullore -2015
3. Koncert i madhe për bashkatdhetarë dhe Festivali i Birrës dhe Verës për tre ditë rresht, duke përfshirë edhe paradën e motoristeve që këtë vit kishte karakter humanitarë, dhe me pjesëmarrje të motoristeve edhe nga mërgata dhe vende të ndryshme të rajonit dhe Evropa, që kanë kontribuar në mbledhjen e fondit për ndërtimin e një shtëpie banimi për skamnorë në komunën tonë.
4. Janë shënuar edhe ditët kulturore të shteteve të ndryshme si Gjermania, Japonia, Amerika, Zvicra, Danimarka, Norvegjia, Suedia, Turqia etj ku jetojnë dhe veprojnë bashkëvendësit tanë në mërgim.
5. Ekspozita "Salloni Vjeshtor", Salloni Vjeshtor ka karakter garues dhe ai gjithashtu është bërë tradicional tashmë, tërhoqi shumë qytetarë dhe artdashës të artit pamor, në këtë konkurs marrin pjesë artistë nga e gjithë bota .

### **Spektori për Rini**

1. Komuna vazhdon t'i përkrah shërbimet rinore në tema të ndryshme dhe projekte të veçanta për edukimin e të rinjve dhe zhvillimin rekreativ sportiv
2. Është zhvilluar java e filmit të shkurtër me prezantimin e filmave të regjisoreve vendës, duke paraqitur për pesë net rresht në ambient të hapur filma të zhanreve tematik për të rinjtë në kuadër të ditëve të mërgatës
3. Kane vazhduar cikle të trajnimeve në tema të ndryshme, aktiviteti me Çiklistë në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, me moto për ruajtjen dhe zhvillimin e turizmit kulturor me pjesëmarrje të mbi 800 çiklisteve dhe shumë qytetarëve
4. Në kuadër të muajit të rinisë janë zhvilluar aktivitetet promovuese për të rinjtë dhe rekreative sportive, me theks të veçantë në kultivimin dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore në Komunën tonë në bashkëpunim me QRTK-Gjilan dhe Muzeun e Kosovës .
5. Në bashkëpunim me OSBE-Gjilan Departamentin e Rinisë dhe Organizatat Rinore në Gjilan duke përfshirë edhe nxënës të shkollave të mesme është organizuar konferenca njëditore për promovimin dhe rregullimin e punës vullnetare të të rinjve.
6. Ndërtimi i Objektivit të Shtëpisë së Rinisë në Gjilan, ka vazhduar dhe në përfundim të punimeve krijohen mundësi dhe hapësira të kënaqshme për dhënien e shërbimeve rinore dhe artistike në nivel komunal.

## **Muzeu- Trashëgimia Kulturore**

1. Është koordinuar puna me forumin kulturor për trashëgimi kulturore dhe me Ministrinë e Kulturës duke qenë pjesë e projektit të përbashkët me organizatën CHWB për renovimin dhe funksionalizimin e galerive të Muzeut sipas standardeve.
2. Komuna e Gjilanit ishte edhe nikoqire e seminarit dy ditore për Trashëgiminë Kulturore me pjesëmarrje të disa komunave nga Franca, Maqedonia dhe Komuna e Gjilanit, me partneritet me Ministrinë e Kulturës, duke shkëmbyer përvoja dhe promovuar vlerat e trashëgimisë kulturore të komunës sonë.
3. Ne bashkëpunim me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore, kemi dërguar tri projekte investive dhe restauruese në MKRS për Sahat Kullën në Gjilan (një projekt i mbetur në gjysmë tash e tre vite më parë), Objekti i tashëm i LDK-se, gjithashtu edhe ndërtimi i Urës në Kalanë e Pogradit është duke u zhvilluar dhe është në ndërtim e sipër në mënyrë që të rritet mundësia e qasjes në mënyrë kala në mënyrë që të mund të zhvillohen aktivitetet kulturore turistike .

## **Biblioteka**

Panairi i Librit u mbajt si çdo herë tjetër, kjo ngjarje e madhe e librit organizohet nga Biblioteka Regjionale “FAN S.NOLI” dhe mbështetet nga Zyra e Kryetarit dhe NJKRS. Ka pas edhe aktivitete tjera lidhur me librin.

## **Spektori i Sportit**

Komuna e Gjilan tanimë ka vazhduar me organizimin e veprimtarive sportive që janë të shumta dhe në të gjitha kategoritë sportive, duke bërë përpjekje që të mbështesim zhvillimin e sportit në përgjithësi, përkundër vështirësive infrastrukturore dhe buxhetore, pasi që sporti ka nevojë dhe kërkesa të shumta në aspektin financiarë, për funksionimin e klubeve sportive të qytetit të Gjilanit.

Paralelisht kemi mbajtur kontaktet e rregullta me MKRS-Departamentin e Sporteve dhe Federatat e Sportit, gjegjësisht me Federatën e Atletikës së Kosovës për të realizuar Vrapimin e Qytetit “Gjilani-2015“, i cili nga viti i kaluar tashmë është shndërruar në Manifestim Ndërkombëtar të Atletikës, ku morën pjesë mbi 283 atletë dhe atlete nga Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi dhe të gjitha klubet nga Kosova, në krahasim me vitet e kaluara ka qenë një organizim më i mirë dhe më masovik , duke ngritur interesimin e atleteve për pjesëmarrje dhe të qytetarëve Gjilanas.

## **Kupa e Presidentit**

Gjatë muajit korrik u mbajt një turne në futboll të vogël ”Kupa e Presidentit”, e organizuar nga NJKRS në bashkëpunim me Forumet Rinore, KVRL dhe Lidhja Rajonale dhe të klubeve dhe shoqatave tjera rinore. E gjithë kjo për t’u mos harruar kjo datë historike e popullit Shqiptar. Në këtë turnir futbollit morën pjesë të 22 ekipe.

## **Strit Boll (Streetbal )**

Strit Boll (basketboll në një kosh) organizimi ishte në nivel të duhur, ekipet pjesëmarrëse të manifestimit ishin të shumta dhe pjesëmarrja e të rinjve ishte e konsiderueshme, e cila është zhvilluar në qendër të qytetit-pllatoja para teatrit.

Në këtë periudhe kemi pas shumë takime pune me përfaqësuesit e firmës punuese Hidroterm të stadiumit ndihmës te (rrethi) e përcjellur nga firma “ Eptisa” si dhe përfaqësues të Komisionit Evropian, ku punimet



janë në fazën finale sipas dinamikës së përcaktuar në mënyrë që objekti të jetë nën menaxhim të Komunitetit dhe të fillon shfrytëzimi për aktivitetet sportive e rekreative

### **Stadiumi i Qytetit:**

Po ashtu është punuar në mënyrë sistematike për mirëmbajtjen e Stadiumit të Qytetit, ku është një gjendje e mirë e stadiumit, duke e ushqyer me pleh artificial dhe farë bari në mënyrë që të ketë kushte të mira për zhvillimin e lojërave kampionate në Futboll. Në proces jemi duke hartuar specifikacionet e projekteve investive për disa pjesë të tribunave dhe objektit të brendshëm në Stadium në mënyrë që të aplikojmë në fondet Qeveritare dhe donatore të mundshëm.

Klubet kanë filluar këtë Kampionat në mënyrë shumë të suksesshme me rezultate konkrete shumë të mëdha, suksese kanë Klubet tona në të gjitha sferat, qoftë si klube ose edhe individ sportiv .

Potencialin sportiv që ka komuna jonë është mjaftë i madh, ndërsa mundësitë tona buxhetore janë shumë të kufizuara, andaj po bëjmë përpjekje që të krijojmë një mbështetje sistematike e proporcionale për të gjitha klubet dhe sportistët tanë, duke krijuar mundësitë që të zhvillohen të gjitha klubet.

### **Pallati i Sporteve:**

Shërbimet në Pallatin e Sporteve janë rritur dhe të gjitha klubet e sporteve me dore si dhe sporteve marciale kanë orarin e rregullt të stërvitjeve dhe garave kampionale, megjithëse vazhdojnë përpjekjet tona që të mirëmbahet objekti në kushte më të mira duke respektuar rendin shtëpiak në Palestër.

Në këtë përdhë raportuese janë evidentuar disa dëmtime në kulmin e palestrës si pasojë e të reshurave të shumta, ndërsa oborri dhe rrethoja nuk janë shumë funksionale dhe paraqesin probleme të vazhdueshëm në objekt, si dhe të njëjtat paraqesin sfidë për punën e mëtutjeshme në Palestrën e Sporteve.

**Rekomandim:** po evidentojmë edhe mundësinë që në proces të shikohet edhe mundësia e dhënies në Partneritet PP, duke konstatuar se parqet një barrë të madhe buxhetore për komunën dhe në mënyrë që të rritet funksionaliteti dhe menaxhimi duke komercializuar hapësirat.

### **Njësia e Auditimit të Brendshëm**

Për periudhën nëntë mujore sipas Planit Vjetor 2015 NJAB-ja, ka arritur t'i kryej 9 auditime ndërsa dy auditime janë në proces.

Në tabelën e mëposhtme do të paraqiten të gjitha auditimet e kryera në nëntëmujorin e vitit 2014 sipas Planit Vjetor dhe sipas shkallës së rrezikshmërisë.

Nr.	Llojet e detyrave të auditimit të Planifikuara dhe të realizuara në nëntëmujorin e vitit 2015	Shkalla e rrezikshmërisë sipas planifikimeve
1	Auditimi në Drejtorinë për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	Rrezik i mesëm
2	Auditimi në Drejtorinë e Inspeksionit	Rrezik i mesëm
3	Auditimi në Drejtorinë për Bujqësi dhe Pyltari	Rrezik i mesëm

4	Auditimi në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa - Procesi i shpenzimeve për të gjitha drejtoritë Komunale (me përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe asaj të Shëndetësisë)	Rrezik i lartë
5	Auditimi në Drejtorinë Komunale të Arsimit - Procesi i Shpenzimeve	Rrezik i lartë
6	Auditimi në Drejtorinë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim	Rrezik i mesëm
7	Auditimi në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (Procesi i shpenzimeve dhe funksionimi i Drejtorisë)	Rrezik i mesëm
8	Auditimi në Njësinë për Kulturë, Rini dhe Sport (ish drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport )	Rrezik i mesëm
9	Auditimi në Drejtorinë Komunale të Arsimit, lidhur me procedurat e plotësimit të vendeve të lira të punës në Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe në shkollat e të gjitha niveleve (auditim me kërkesë të Kryetarit të Komunës)	Rrezik i lartë
<b>Auditimet të cilat me 30.09.2015 kanë qenë në proces</b>		
10	Auditimi në Departamentin e Prokurimit (është në fazën e përpilimit të Draft Raportit)	Rrezik i lartë
11	Auditimi i të hyrave nga Tatimi në Pronë (është në fazën e testeve)	Rrezik i lartë

Vlerësimi i objektivave për auditime sipas shkallës së rrezikshmërisë është bërë në Planin Strategjik të NJAB-së për vitet 2015 – 2017, planë ky i aprovuar po ashtu nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm dhe nga Kryetari i Komunës. Në këtë nëntë mujor, NJAB-ja ka arritur objektivat e planifikuara me Planin Vjetor për vitin 2015, me që ka arritur t'i kryej nëntë auditime të cilat kanë pasur një fushëveprim mjaft të gjerë dhe kompleks dhe dy auditime janë në proces (në Departamentin e Prokurimit dhe në Sektorin e Tatimit në Pronë). Kanë mbetur për t'u kryer edhe tri auditime (Në Drejtorinë për Shëndetësi-Procesi i të Hyrave, Menaxhimi i Pasurisë Komunale, dhe në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik).

## Zyra Ligjore

### Aktivitetet e zyrës ligjore

Nr.	Aktivitetet	
1	Hartimi, ndryshimi, plotësimi i statuteve, rregulloreve e akteve tjera	<b>30</b>
2	Bartje e lëndëve	<b>1</b>
3	Debate/Dëgjime publike	<b>8</b>
4	Draft-plane të veprimit/punës	<b>2</b>
5	Kërkesa për nivelin lokal	<b>2</b>
6	Kërkesa për nivelin qendror	<b>6</b>
7	Konkurse	<b>2</b>
8	Konsultime/këshilla ligjore-juridike	<b>40</b>
9	Njoftime	<b>25</b>
10	Opinione/Interpretime ligjore	<b>18</b>
11	Procesverbale	<b>14</b>
12	Projekt-kontratë/marrëveshje mirëkuptimi	<b>37</b>
13	Projekt-vendim	<b>72</b>
14	Qarkore ligjore	<b>8</b>
15	Raporte	<b>6</b>

16	Seanca e KK-së	4
17	Seanca e komisionit të ankesave	5
18	Seanca e KPF-së	7
19	Takim/punëtori pune	93
20	Urdhëresa	2
21	Autorizime/Letër mbështetëse	0
22	Seanca të komisionit për shitjen e banesave	2
23	Takim/punëtori pune	0
24	Urdhëresa	0
25	Vlerësime pune	3
26	Dëgjime publike	0
27	Pyetësor	2
28	Raporte	0
29	Seanca gjyqësore në çështje juridike të ndryshme	242
30	Përgjigje me shkrim në padi	78
31	Ankesa kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë	22
32	Padi	3
33	Prapësim	4
34	Revizione	2
35	Përgjigje në ankesë	8
36	Përgjigje në prapësim	1
37	Propozim për kundër përmbarrim	1
38	Përgjigje në mbrojtje	1
39	Kundërshtim ndaj caktimit të masës së përkohshme	2
40	Vlerësime pune	3
<b>Gjithsejtë:</b>		<b>756</b>

Korrigjime/lektyrime të dokumenteve për këtë periudhë kohore gjithsej: 558 faqe.

## Zyra për informim

Një segment shumë i rëndësishëm brenda qeverisjes komunale, është Zyra për Informim, e cila përcjellë aktivitetet e Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal dhe drejtorive dhe të gjitha këto i prezanton para publikut. Në këtë funksion, Zyra për Informim, përmes informacioneve ditore, raporteve, komenteve dhe njoftimeve të tjera, realizon transparencën e qeverisjes kundrejt publikut.

Gjatë kësaj periudhe, Zyra për Informim ka përgatitur dhe edituar në web faqen e Komunës si dhe ka shpërndarë për media, më se **550 informacione ditore**, për më pak se 200 ditë pune, duke bërë kështu të mundur që puna e institucioneve vendimmarrëse dhe ekzekutive të jetë sa më transparente.

Kryetari i Komunës, pos aktivitetit të përditshëm, ka pritur në zyrën e tij mbi 50 përfaqësues të pushtetit qendror, përfshirë presidenten, kryeministrin, ministrat, pastaj autoritete të tjera vendore e ndërkombëtare, qytetarë si dhe ka realizuar vizita të rëndësishme në SHBA, Gjermani, Bruksel, Austri, Turqi, Zvicër, Shqipëri dhe vende tjera dhe i ka sjellë Gjilanit “Çmimin e qytetit model për investime” dhe së fundi edhe pranimin në Konventën e kryetarëve të Komunave në Bruksel. Brenda kësaj periudhe kohore janë përgatitur **dy numra të Buletinit**, si një mundësi tjetër për të pasuruar transparencën e pushtetit kundrejt publikut.

## Zyra për Integritet Evropiane

Zyra për Integritet Evropiane në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësi të saja, gjatë këtij nëntëmujori ka paraqitur raportet të kërkuara nga organet qendrore e sidomos që kanë të bëjnë me raportin e Marrëveshjes së Asociimit Stabilizimit, raportit të progresit etj.

Pos kësaj janë kryer edhe këto aktivitete:

- monitoron dhe përcjell të gjitha aktivitetet e komunës, të organeve të saja;
- manifestimet që lidhen me shënimin e ditës së Evropës dhe manifestime tjera;
- organizimin e debateve të ndryshme lidhur me promovimin e vlerave evropiane;

Zyra ka ushtruar detyrat e saja në kuadër të kompetencave që i ka të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore.

## Departamenti i Prokurimit

Aktivitetet e kryera

### Publikimi i njoftimeve në KRPP-së

Tipi i njoftimeve	Nr. i njoftimeve të publikuara
Njoftim për kontratë	67
Njoftim për konkurs të projektimit	2
Njoftim për dhënie të kontratës	70
Njoftim për dhënie të kontratës (Ankand Publik)	1
Njoftim mbi rezultatin e konkursit të projektimit	2
Anulim i dhënies së kontratës	2
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>144</b>

Fazat e tenderimit se deri ku kanë arritur procedurat tenderuese:

Nr.	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Faza e tenderimit	Vlera në €
1	Furnizim me material Biokimik Hematologjik për QKMF- viti 2014	Është nënshkrua kontrata	49,949.00
2	Hartimi i planit rregullues të hollësishëm Fidanishtja 2	Është nënshkrua kontrata	53,393.00
3	Furnizim me material botues	Është nënshkrua kontrata	71,069.90
4	Asfaltim i rrugës në lagjen e Zabeli i Sait Agës (Aneks kontratë)	Janë realizuar punët	20,099.36
5	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve 2015 në qytet	Është nënshkrua kontrata	6,500.00
6	Pastrimi i rrugëve rurale nga bora në Komunën e Gjilanit	Është nënshkrua kontrata	6,050.00
7	Servisimi dhe Mirëmbajtja e automjeteve	Është nënshkrua	44,870.00

		kontrata	
8	Hartimi i projekteve kryesore në Komunën e Gjilanit - lot I	Është nënshkrua kontrata	25,412.00
9	Hartimi i projekteve kryesore në Komunën e Gjilanit - lot II	Është nënshkrua kontrata	18,364.54
10	Furnizim me IT-is për të gjitha njësitë shpenzuese për regjionin e Komunës së Gjilanit	Është nënshkrua kontrata	Kontratë kornizë
11	Furnizim me tonerë për të gjitha njësitë shpenzuese për regjionin e Gjilanit	Është nënshkrua kontrata	53,363.20
12	Furnizim me material administrativ për zyre	Është nënshkrua kontrata	24,272.30
13	Transporti i punëtorëve dhe nxënësve lot II	Është nënshkrua kontrata	19,375.20
14	Transporti i punëtorëve dhe nxënësve LOT V	Është nënshkrua kontrata	23,680.80
15	Transport i nxënësve në Komunën e Gjilanit LOT I	Është nënshkrua kontrata	16,394.40
16	Transporti i nxënësve të Komunës së Gjilanit lot IV	Është nënshkrua kontrata	23,448.96
17	Transporti i nxënësve të Komunës së Gjilanit lot VI	Është nënshkrua kontrata	5,336.00
18	Transporti LOT III-Gumnishtë –Gumnishtë e Epërme	Është nënshkrua kontrata	15,897.60
19	Servisimi dhe riparimi i veturave të Komunës së Gjilanit	Është nënshkrua kontrata	985.00
20	Furnizim me fishekzjarre për nder të ditës së Pavarësisë	Është nënshkrua kontrata	2,600.00
21	Furnizim me fletore dhe lapsa kimik për nder të “7 Marsit” Dita e Mësuesit	Është nënshkrua kontrata	6,966.00
22	Furnizim me material për manifestime kulturore	Është nënshkrua kontrata	9,135.00
23	Furnizim me repromaterial për serra dhe pemishte për nevoja të Shkollës së Mesme e Bujqësisë" Arbëria-Gjilan	Është nënshkrua kontrata	6,984.00
24	Furnizim me farë misri dhe pleh artificial	Është nënshkrua kontrata	32,977.00
25	Mirëmbajtja teknike e objekteve Komunale	Është nënshkrua kontrata	378,516.75
26	Furnizim me medikamente për nevoja të QKMF	Është nënshkrua kontrata	4,355.00
27	Transporti i punëtorëve dhe nxënësve me nevoja të veçanta lot I	Është nënshkrua kontrata	5,772.00
28	Transporti i organizuar i punëtorëve Lot II	Është nënshkrua kontrata	6,590.00
29	Furnizim me laptop, printer, projektor për projektin valorizimi i zejeve tradicionale për Komunën e Gjilanit	Është nënshkrua kontrata	1,935.00
30	Furnizimi dhe montimi i aparaturës digjitale për numërim, votim dhe lexim elektronik për sallën e re të Kuvendit	Është nënshkrua kontrata	23,390.00
32	Furnizim me inventarë për nevoja të Komunës	Është nënshkrua kontrata	32,245.00

33	Kryerja e shërbimeve-sigurimi i biletave me aviokompani	Është nënshkrua kontrata	20.00
34	Transporti i nxënësve me nevoja të veçanta	Është nënshkrua kontrata	840.00
35	Hartimi i planeve rregulluese Qarku II,III dhe Lagjja te Spitali	Njoftim për dhënie	
36	Furnizim me farë bari dhe pleh artificial për stadiumin e qytetit	Është nënshkrua kontrata	840.00
37	Unifikimi i mbishkrimeve për drejtoritë dhe zyrat e komunës	Është nënshkrua kontrata	9,481.00
38	Trajtimi i qenve endacak në qendrën e azilit në fshatin Zhegoc	Është nënshkrua kontrata	10,000.00
39	Furnizim me aparat për kartela hyrëse –dalëse të punëtorëve	Është nënshkrua kontrata	5,436.00
40	Mirëmbajtja verore e rrugëve dhe trotuareve te qytetit	Është nënshkrua kontrata	161,780.00
41	Rrënimi i objektit të vjetër të shkollës dhe largimi i deponive të egra në fshatin Velekincë	Është nënshkrua kontrata	9,677.00
42	P.P.P- Rregullimi i infrastrukturës te kompleksi te shkollat e mesme në Komunën e Gjilanit	Njoftim për dhënie	
43	Rregullimi i terreneve sportive -vazhdim i projektit	Janë duke u realizuar punimet	111,335.69
44	Asfaltimi i rrugës kah deponia	Janë duke u realizuar punimet	54,777.20
45	Asfaltimi i rrugës Përlepnice - Vali Ranq	Janë duke u realizuar punimet	245,825.89
46	Ushqim për kafshë te Shkolla e Mesme e Bujqësisë	Njoftim për dhënie	55,700.00
47	Furnizim me lule dhe kurora për manifestime të ndryshme	Është nënshkrua kontrata	4,355.00
48	Asfaltimi i rrugës së Gjilan-Bujanoc	Është nënshkrua kontrata	896,274.83
49	Rregullimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në rr Gjilan -Velekinc	Është nënshkrua kontrata	65,757.29
50	Subvencionimi i normës së interesit për kredit e biznesit mikro dhe agro	E anuluar	
51	Ofrimi i shërbimeve të varrimit në Komunën e Gjilanit	Është nënshkrua kontrata	155,950.00
52	Rregullimi i kanalizimit fekal në fshatin Dobërçan	Është nënshkrua kontrata	9,788.50
53	Mirëmbajtja e kontabilitet në QKMF (programit)	Është nënshkrua kontrata	840.00
54	Furnizim me atomizera spërkatës për nevoja të Drejtorisë së Bujqësisë	Është nënshkrua kontrata	16,500.00
55	Aplikim online për nxjerrjen e dokumenteve në gjendjen civile	Është nënshkrua kontrata	960.00
56	Rregullimi i kanalizimit atmosferik në rrugën “15 Qershori”-Gjilan	Janë duke u realizuar punimet	45,059.42
57	Asfaltim i rrugëve në fshatin Shillovë	Janë duke u realizuar punimet	35,454.33
58	Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal në Komunën e Gjilanit	Njoftim për dhënie	96,888.00

59	Furnizim me material për organizimin e festave të qershorit 2015	Është nënshkrua kontrata	7,495.00
60	Hapja dhe trasimi i rrugës sipas planeve rregulluese Fidanishtja I	Është nënshkrua kontrata	25,547.10
61	Asfaltim i rrugëve në fshatin Zhegër	Janë duke u realizuar punimet	95,512.34
62	Furnizim me tonerë për të gjitha njësit shpenzuese për regionin e Gjilanit	Është nënshkrua kontrata	8,963.00
63	Furnizimi dhe montimi i kamerave në zyrat e gjendjes civile nëpër fshatra	Në fazën e vlerësimit	8,976.00
64	Asfaltimi i rrugëve në lagjen nr. VIII "Motrat Qiriazit dhe "Hasan Tasini"( 2014)	Janë duke u realizuar punimet	87,567.41
65	Mirëmbajtja e nxejve në institucionet komunale (2014)	Është nënshkrua kontrata	118,906.90
66	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve procedurat e filluara në vitin( 2014)	Është nënshkrua kontrata	59,011.00
67	Furnizim me artikuj ushqimor për institucionet parashkollore, konviktin e nxënësve dhe për nevoja të njësisve tjera shpenzuese (2014)	Është nënshkrua kontrata	59,856.00
68	Furnizim me material stomatologjik për QKMF (2014)	Është nënshkrua kontrata	122,799.00
69	Asfaltimi i rrugës “Molla Idrizi”-Gjilan	Janë duke u realizuar punimet	105,805.20
70	Furnizim me dru për ngrohje për të gjitha njësit shpenzuese të Komunës së Gjilanit	Para nënshkrimit të kontratës	259,540.00
71	Rregullimi i trotuarit përgjatë rrugës Lladovë – Zhegër	E anuluar	
72	Shitja e masës drusore të pa prera në fshatin Zhegoc	Në procedurë të tenderimit	2.861.77
73	Ftesë për ofertim për shitje të frutave-dredhëzave	E anuluar	
74	Ftesë për ofertim për shitje të viçave	Është nënshkrua kontrata	5,717.00
75	Asfaltimi i rrugës në lagjen “Arbëria”	Është nënshkrua kontrata	43,740.50
76	Asfaltimi i rrugës “Muharrem Kurteshi”	Është nënshkrua kontrata	99,825.40
77	Asfaltimi i rrugës “Rukije Haliti”dhe “Vëllezërit Llozana”	Është nënshkrua kontrata	93,120.12
78	Asfaltimi i rr në fsh Dobërqan	Është nënshkrua kontrata	50,177.00
79	Asfaltimi i rr në fsh Livoq i Ulët	Është nënshkrua kontrata	29,733.30
80	Asfaltimi i rr në fshatin Velekincë	Në procedurë	
81	Rregullimi I kanalizimit fekale në fshatin Përlepnice	Në procedurë	
82	Manifestimi tradicional ditët e diasporës 2015	Është nënshkrua kontrata	9,744.00
83	Punimi i bexhave për këshilltarët e Komunës	Është nënshkrua kontrata	962.50
84	Kontrollimi i kualitetit të ekzekutimit të punimeve - Gjilan		
85	Rregullimi i varrezave te Kodra e Dëshmorëve	Është nënshkrua	55,629.18

		kontrata	
86	Rregullimi i kanalizimit fekal në lagjen te Vishnjat - Gjilan	Është nënshkrua kontrata	39,708.33
87	Implementimi i projektit të Kioskave për shërbim të gjendjes civile	Njoftim për dhënie	16,500.00
88	Rregullimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik Gjilan-Velekincë	Është nënshkrua kontrata	65,757.29
89	Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Lladovë	Në procedurë	
90	Furnizim me naftë për ngrohje	Në procedurë	
91	Ofrimi i shërbimeve këshilluese për PPP	Në vlerësim	
92	Rregullimi i kanalizimit në fshatin Bresalcë	Në procedurë	
93	Pastrimi i lumenjve dhe vendosja e lëshesave	Është nënshkrua kontrata	9,864.00
94	Rregullimi i rrethojës së murit te spitali rajonal	Është nënshkrua kontrata	9,876.54
95	Renovimi i objektit komunal për info qendrën		
96	Mbikëqyrja e projekteve investive në Komunën e Gjilanit	Është nënshkrua kontrata	9,500.00
97	Transporti i nxënësve në relacionin Kravaric-Cërrnicë dhe anasjelltas	Njoftim për dhënie	25,833.60
98	Pune në distancë telework pilot projekt	Është nënshkrua kontrata	3,500.00
99	Furnizim me shporta ricikluese për reduktimin e mbeturinave	Është nënshkrua kontrata	7,760.00
100	Hapja dhe trasimi i rrugëve sipas planit rregullues Urban “Montith”	Në procedurë	
101	Furnizim me ushqim për kafshe për nevoja te Shkolla e Mesme e Bujqësisë “Arbëria” -Gjilan	Njoftim për dhënie	55,700.00
102	Asfaltim i rrugëve në fshatin Cërrnicë	Në vlerësim	
103	Furnizim me çarçaf otomanë dhe mbulesa për jastëk	Njoftim për dhënie	9,680.00
104	Meremetimi dhe ndërtimi i shtëpive për raste sociale	Në procedurë	
105	Mirëmbajtja dimërore -verore e rrugëve	Në procedurë	
106	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bresalcë	Në procedurë	

## Menaxhimi i kontratave

### Sfidat

Pas konstatimit se në projektin “ Ndërtimi i terreneve sportive në fshatrat e komunës së Gjilanit” ka ngecje në ekzekutim të punëve dhe pas dhënies së disa vërejtjeve me shkrim, kemi qenë të obliguar që sipas kushteve të kontratës dhe në bazë të marrëveshjes së arritur me punëkryesin të bëjmë ndërprerjen e kontratës, ndërsa për dëmet e shkaktuara për mos realizim të projektit sipas planit dinamik, kemi marrë vendim për dënimin e kompanisë me 10% për punët e pa përfunduara.

Në vazhdimësi kemi pranuar raportet nga Organet Mbikëqyrëse lidhur me realizimin e projekteve për të cilat janë hartuar raporte për shkallen e realizimit te të gjitha projektet..

Është bërë edhe menaxhimi financiar i projekteve të realizuara në bashkëfinancim me Ministrin e Infrastrukturës dhe Ministrin e Pushtetit Lokal duke përgatitur raportet mbi gjendjen dhe rrjedhjen e projekteve (anën financiare dhe anën ekzekutive të projekteve).



Janë zhvilluar procedurat tenderuese dhe janë nënshkruar kontratat për projektet e financuara nga Ministria e Infrastrukturës.

Për asfaltimin e rrugëve në fshatra janë nënshkruar pesë (5) kontrata në vlerë **476,025.73 €** dhe tri projekte janë në procedurë.

Për projektet në qytet të financuara nga MI janë nënshkruar kontratat për pesë (5) projekte në vlerë **1,238,766.05€**.

Janë udhëhequr procedurat tenderuese për projektin e PPP-së “Rregullimi i infrastrukturë së kompleksit të shkollat e mesme” dhe tani jemi në fazën e Njoftimit për dhënie të kontratës.

Gjithashtu nga Departamenti i Prokurimit është përcjell edhe realizimi i kontratave dhe i është bërë kërkesë kompanive për fillimin e punëve në të gjitha projektet për të cilat i kanë nënshkruar kontratat, por nuk i kanë filluar punimet.

Departamenti i Prokurimit po vazhdon me aktivitetet e filluara gjatë nëntëmujorit e pritët që disa prej tyre të përfundojnë gjatë muajve në vijim.

## Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Që nga nënshkrimi i memorandumit për mirëkuptim në nëntor të vitit 2014 për projektin- EU-RRK-4-ZKKK kemi pasur tri runda me gjithsejtë 10 takime me TASK –forcën dhe 4 takime të grupit punues komunal për kthim nga projekti RRK-4 ku janë miratuar apo aprovuar 13 raste nga të cilat 2 familje janë të komunitetit rom dhe 11 të komunitetit serb. Për këtë periudhë raportuese janë ndërtuar 8 shtëpi, kurse në ndërtim e sipër janë edhe 5 të tjera.

Tab.1

Shtetet nga të cilat janë riatdhesuar familjet

Shteti	Familje	Anëtar	Meshkuj	Femra	Fëmijë
Luksemburg	1	1	1	/	/
Franca	9	19	9	4	6
Gjermani	76	203	75	39	89
Austria	12	22	12	3	7
Zvicra	10	11	10	1	/
Holanda	2	3	2	1	/
Hungari	5	5	5	/	/
Belgjika	1	1	1	/	/
Shtet i panjohur	18	33	18	7	8
<b>Gjithsejtë</b>	<b>134</b>	<b>298</b>	<b>133</b>	<b>50</b>	<b>110</b>

Tabela.2

Familjeve të riatdhesuara në mënyrë të dhunshme dhe vullnetarisht.

Dhunshëm	116
Vullnetarisht	18
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>134</b>

Tabela.3

Numri i përgjithshëm të kthyer këto familje

Qytet	85
Fshat	49
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>134</b>

Paraqitja tabelare e të riatdhesuarve si individ apo familje

Tabela.4

Të riatdhesuarit familje dhe individ

Familje	54
Individ	80
<b>Gjithsejtë:</b>	<b>134</b>

## Zyra për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc

Gjatë këtij nëntë mujori ZPBM, është marre kryesisht me identifikimin e problemeve të qytetarëve të dëbuar nga Kosova Lindore, të cilët jetojnë në Komunën e Gjilanit, në periudhën kohore janar-shtator, zyrën e kanë vizituar 1221 qytetarë nga të cilët 428 qytetarë kanë probleme me dokumentacion identifikimi.

Zyra gjatë kësaj periudhe, ka pasur takime informuese me Ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Ambasadorin Norvegjez në Kosovë, takime me Policinë lokale në Gjilan, Kryetarin e Komunës së Bujanocit, Kryetarin e Këshillit Nacional Shqiptarë në Serbi, takime me Deputetet Shqiptarë në Parlamentin e Serbisë.

Zyra jonë ka ofruar asistencë për pjesëmarrjen e prodhuesve nga Lugina, në Panairin e prodhimeve vendore “Gjilani 2015”, takim me udhëheqësin e Shoqatës Kulturore e Artistike “Shqiponjat e Medvegjës”, takim informues me zyrtar të Programit për të Drejtat Civile në Kosovë, dega Gjilan. CRP/K, takim me Rektorin e Universiteti Publik “KADRI ZEKA” në Gjilan etj

Ju faleminderit!